

Veriu i Kosovës në vitin 2020

Historitë e së ardhmes në zhvillim



Rreth autorëve

Regina Joseph është bashkëpunëtore e lartë për parashikimin e sigurisë në të ardhmen në Institutin 'Clingendael', ku merret me krijimin e skenarëve dhe parashikimeve të ndryshme që kanë të bëjnë me çështje të sigurisë. Ajo është gjithashtu themeluese e organizatës konsulente për të ardhmen 'Sibylink' (www.sibylink.com) si dhe parashikuese dhe konsulente e lartë për Projektin "Vlerësimi i Mirë" i financuar nga IARPA (www.goodjudgmentproject.com).

Jitske Hoogenboom është zyrtare e lartë e Programit për Kosovën në organizatën PAX. Ajo ka qenë përgjegjëse për Programin për Kosovën që nga viti 2009, me fokus të veçantë në Mitrovicë, dhe po udhëheq avokimin ndërkombëtar të organizatës PAX për çështjet e ndërtimit të paqes në Kosovë.

Falënderojmë

Ky punim nuk do të mund të realizohej pa ndihmën dhe pjesëmarrjen e organizatës Community Building Mitrovica në rajonin e Mitrovicës dhe Qendrës për Zhvillimin e Komuniteteve në Komunën e veriut të Mitrovicës. Autorët e këtij raporti dëshirojnë të shprehin vlerësimin e lartë për personelin e këtyre organizatave, për kohën dhe energjinë e shpenzuar. Gjithashtu, dëshirojmë të falënderojmë Forumin për Marrëdhënie Etnike nga Beogradi për ndihmën dhe pjesëmarrjen në këtë punim, duke na mundësuar për një kohë të shkurtër qasje të jashtëzakonshme tek njerëzit në Serbi. Gjithashtu falënderojmë z. Zoran Nechev nga Shoqata 'Zenith' në Shkup për informacionet e vlefshme për të fituar një 'tablo më të plotë mbi Ballkanin'. Falënderojmë z. Filip Rakic i cili ishte udhërrëfyesi ynë gjatë fotografimit të Komunës veriore të Mitrovicës. Falënderimet gjithashtu shkojnë për Pieter-Jan Baas, Mathieu Hermans, Miroslav Lazarevic dhe Helma Maas që na kanë lejuar t'i shfrytëzojmë fotot e tyre. Mbi të gjitha, ne shprehim mirënjohjen dhe vlerësimin e sinqertë për banorët e pjesës veriore të Kosovës dhe të gjithë ata që kishin mirësinë për të ndarë kohën e tyre për intervistat tona hulumtuese, si dhe personat që rishikuan verzionin preliminar të këtij raporti. Gjithashtu i shprehim mirënjohje znj. Susan Sellars për redaktimin e raportit dhe Het IJzeren Gordijn për dizajnin grafik. Në fund, falënderimet e veçanta shkojnë për znj. Linda Schevers për përkushtimin e saj të pashoq që projekti dhe ky raport të jetësohen. ♦

Përshkrimi i shkurtë i publikimit

Autorët: Regina Joseph dhe Jitske Hoogenboom
Botuesit: Regina Joseph dhe Susan Sellars
Fotografia në ballinë: Pieter-Jan Baas; Pamje rruge në veri të Mitrovicës
Dizajni grafik: Het IJzeren Gordijn
ISBN: 978-90-70443-76-4 | NUR 689 | PAX2014/004b
Maj 2014

Rreth partnerëve të projektit

Ky raport është fryt i një projekti të përbashkët të realizuar nga organizata PAX (agjenci udhëheqëse), Zhvillimi i Komuniteteve në Mitrovicë (CBM) dhe Qendra për Zhvillimin e Komuniteteve (CRZ). Planin e veprimit e ka përgatitur Instituti për Hulumtim 'Clingendael', intervistat në Beograd i ka organizuar Forumi për Marrëdhënie Etnike, përderisa të gjitha organizatat tjera partnere të përfshira në këtë projekt e kanë rishikuar raportin në mënyrë gjithëpërfshirëse. Bashkautorë të këtij raporti janë Regina Joseph (Clingendael) dhe Jitske Hoogenboom (PAX).

Rreth organizatës PAX (më parë e njohur si IKV Pax Christi)

Fjala PAX do të thotë paqe. Organizata PAX i bashkon njerëzit që kanë guximin ta mbështesin paqen. PAX punon së bashku me njerëzit nga vendet e përfshira në konflikt dhe popujt e tërë botës në krijimin e shoqërive të denja, demokratike dhe paqësore anë e mbanë globit. Në Kosovë kjo organizatë punon në tre drejtime kryesore: fuqizimin e shoqërisë civile në veri të Kosovës, fuqizimin e aktivizmit qytetar dhe pjesëmarrjes së publikut në veri të Kosovës dhe fuqizimin e transparencës dhe përfshirjes në proceset e vendim-marrjes, duke përfshirë edhe proceset e BE-së.

www.paxforpeace.nl | info@paxforpeace.nl

Rreth Qendrës për Zhvillimin e Komuniteteve

Qendra për Zhvillimin e Komuniteteve (CRZ) është themeluar në vitin 2006 në Komunën e veriut të Mitrovicës si rezultat i bashkëpunimit të disa organizatave jo-qeveritare të serbëve të Kosovës. Misioni i CRZ-së është të adresojë nevojat prioritare të komunitetit serb në veriun e Kosovës. CRZ identifikon nevojat e serbëve të Kosovës për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre. Kjo ndihmon në përcaktimin e zgjidhjeve adekuate për zhvillimin e komuniteteve vendore dhe inkurajon bashkëpunimin në mes komuniteteve në rajon. Me qëllim të përmirësimit të kapitalit shoqëror të komuniteteve vendore, CRZ-ja ndërmerr iniciativa dhe zhvillon procese të llojllojshme të mësimi dhe programeve arsimore, duke mbështetur fuqishëm vlerat thelbësore demokratike.

www.crzmitrovica.com



Rreth Zhvillimi i Komuniteteve në Mitrovicë

Community Building Mitrovica/Zhvillimi i Komuniteteve në Mitrovicë (CBM), me seli në Mitrovicë, është organizatë ndëretnike që vepron në nivel lokal, e cila identifikon, inkurajon dhe ndihmon veprimet e përbashkëta të qytetarëve në rajonin e Mitrovicës me qëllim të promovimit të bashkëpunimit, bashkëjetesës dhe vlerave demokratike. Personeli i organizatës CBM përbëhet nga qytetarë të devotshëm - të kombësisë serbe dhe shqiptare - të cilët janë rritur në këtë rajon dhe dëshirojnë të rikthejnë mirëbesimin dhe miqësinë e së kaluarës, të cilat lufta dhe politika i kanë shkatërruar. Fushat në të cilat punon organizata CBM janë: qeverisja e mirë, mjetet e informimit, kultura, rinia, gratë, pakicat, arsimit joformal, të drejtat e njeriut, dialogu dhe kthimi i refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit.

www.cbmitrovica.org

Rreth Clingendael

Instituti holandez për Marrëdhënie Ndërkombëtare 'Clingendael' është organizata kryesore think tank holandeze dhe akademi diplomatike për çështjet ndërkombëtare. Ky institut u ofron organizatave publike dhe private analiza të thella dhe gjithëpërfshirëse mbi zhvillimet globale në fushat e diplomacisë ekonomike, sigurisë ndërkombëtare dhe menaxhimit të konflikteve. Clingendael në mënyrë specifike fokusohet në pozitën dhe rolin e shtetit holandez.

www.clingendael.nl

Rreth Forumit për Marrëdhënie Etnike

Forumit për Marrëdhënie Etnike (FME) me seli në Beograd është themeluar në vitin 1989 si rrjet i 110 akademikëve dhe ekspertëve për çështje kombëtare, marrëdhënie etnike dhe mbrojtjen e pakicave. Anëtarët e forumit janë shkencëtarët dhe ekspertët e mirënjohur nga ish-Jugosllavia, Evropa dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. FME-ja mbështet ndërtimin e institucioneve demokratike dhe kontribuon në zgjidhjen paqësore dhe demokratike të konflikteve etnike, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e pakicave. FME-ja, në bashkëpunim me qeveritë me orientime demokratike, organizon hulumtime akademike, programe trajnimi dhe projekte të ngjashme, me qëllim të demokratizimit të mëtutjeshëm të shoqërive me të cilat punon.

www.fer.org.rs ♦

Parathënia

Zhvillimet politike në Kosovë dhe Serbi kanë evoluar me shpejtësi gjatë viteve të fundit. Fillimi i dialogut mes Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e BE-së, në muajin mars të vitit 2011, ka rivendosur komunikimin mes këtyre dy vendeve dhe ka rezultuar me arritjen e Marrëveshjes së parë mbi parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve, në muajin prill të vitit 2013, e cila ka ndryshuar rregullimin institucional të veriut të Kosovës. Zhvillimet politike po vazhdojnë me një ritëm të qëndrueshëm.

Ky raport mbështetet në gjetjet nga vizitat gjithëpërfshirëse të bëra në terren gjatë muajit janar të vitit 2014. Që atëherë, në Serbi janë mbajtur zgjedhjet parlamentare, kurse në kohën e publikimit të këtij raporti fushata elektorale e zgjedhjeve parlamentare në Kosovë kishte arritur kulmin. Shtetet anëtare të Bashkimit European dhe Kosova kanë arritur marrëveshje për rregullimin dhe ripërtëritjen e mandatit të EULEX-it si dhe janë pajtuar me themelimin e Gjykatës speciale në Hagë, për gjykimin e krimeve të luftës. Përbërja e Parlamentit European ka pësuar ndryshime, prandaj edhe ndryshimet në udhëheqjen e Komisionit European dhe Shërbimit European për Veprim të Jashtëm janë të pashmangshme. Disa nga aktorët kryesorë politik të tanishëm me gjasë do të zëvendësohen në fund të vitit 2014.

Një element konstant që i ka karakterizuar këto zhvillime të shpejta politike ka qenë mungesa e transparencës dhe mos përfshirja e qytetarëve në proceset rreth dialogut dhe marrëveshjeve të arritura. Pas vitit 2013, që ishte një vit shumë i tensionuar dhe nganjëherë edhe i dhunshëm, gjendja është përmirësuar dhe nga muaji shkurt i këtij viti ka mbretëruar një qetësi relative. Sidoqoftë, më shumë se një vit pas arritjes së marrëveshjes së prillit, banorët e veriut të Kosovës vazhdojnë të ndihen të pasigurt për ndikimin e këtyre marrëveshjeve në jetën e tyre të përditshme. Çka do ndryshojë për ta? Ndonëse janë ata që do të preken më së shumti nga

marrëveshjet në fjalë, qytetarët në veri të Kosovës ndihen të përjashtuar dhe të painformuar për procesin dhe rezultatet e tij.

Me qëllim të parashikimit të skenarit për Veriun e Kosovës në vitin 2020, kemi biseduar me më shumë se 40 njerëz nga kjo pjesë e Kosovës. Bisedat shpesh ishin të vështira; njerëzit janë të irrituar dhe të zemëruar për shkak të gjendjes aktuale dhe brengosen për të ardhmen e tyre. Shpeshherë bisedat nxorën në pah mendime interesante, informata të reja dhe perspektiva të reja. Pavarësisht ndryshimeve të shpejta politike të përshkruara më lartë, mendimet e shprehura nga njerëzit e intervistuar janë të rëndësishme dhe duhet të merren parasysh me rastin e hartimit të politikave në të ardhmen.

Aktorët e rinj që do të vijnë në pushtet do të jenë në pozitë që ta ndryshojnë dinamikën dhe të ofrojnë mundësi të reja për përmirësimin e gjendjes në veriun e Kosovës dhe zonat përreth saj. Përmes këtij raporti, PAX dhe partnerët e saj synojnë t'iu ofrojnë politikëbërësve të përfshirë në veriun e Kosovës dhe në marrëdhëniet Kosovë-Serbi çështje që ia vlen të shqyrtohen seriozisht, duke iu prezantuar perspektivat e njerëzve dhe duke i projektuar këto perspektiva në të ardhmen. Përveç kësaj, organizata PAX shpreson se ky raport do të kontribuojë në informimin më të mirë të politikëbërësve, komunikimin gjithëpërfshirës si dhe mirëkuptimin e dyanshëm mes hartuesve të politikave dhe qytetarëve të pjesës veriore të Kosovës.

Njerëzit në veri të Kosovës i meritojnë përpjekjet tona.

Jitske Hoogenboom, PAX
26 Maj 2014 ♦

Përmbytja

Përmbledhje Ekzekutive	9
Rëkomandimet	13
Veprimet e menjëhershme	13
Veprimet afat-shkurtra (0–2 vite)	15
Veprimet afat-mesme (1–3 vite)	17
1. Hyrje dhe Metodologjia	18
1.1 Metodologjia	19
2. Këndvështrimi nga terreni	20
2.1 Nga veriu	20
2.2 Nga jugu	21
3. Skenarët	26
3.1 Skenari Një: Kali dhe uji	27
3.2 Skenari Dy: Tranzicioni	31
3.3 Skenari Tre: Qorrsokaku dhe pranimi i gjendjes	35
3.4 Skenari Katër: Relapsi - Kthimi në gjendjen paraprake	37
4. Shtytësit	40
4.1 Shtytësit politik	40
4.2 Shtytësit e sigurisë	47
4.3 Shtytësit Ekonomik	50
4.4 Shtytësit socio-kulturor	52
5. Çështjet kryesore	56
5.1 Uji	57
5.2 Rryma	58
5.3 Arsimi	59
5.4 Mjetet e informimit dhe telekomunikacioni	60
5.5 Industria e rëndë	62
6. Përfundimi	64
Fusnotat	66
Lista e figurave	
Matriksi i Skenarit	25
Skenari Një – Kali dhe uji	26
Skenari Dy – Tranzicioni	30
Skenari Tre – Qorrsokaku dhe pranimi i gjendjes	34
Skenari Katër – Relapsi - Kthimi në gjendjen paraprake	36
Shtytësit	41

Shkurtesat

FAK	Forcat e Armatosura të Kosovës
BIK	Bashkësia Islame e Kosovës
EEAS	Shërbimi European për Veprim të Jashtëm
BE	Bashkimi European
EULEX	Misioni European për Sundimin e Ligjit në Kosovë
BPV	Bruto produkti vendor
KEDS	Kompania kosovare për shpërndarje të energjisë dhe furnizim
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Forcat e NATO-s në Kosovë
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
LISBA	Lëvizja Islame “Bashkohu”
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
SJCRKC	Komiteti i Përbashkët Saudit për Rindërtimin e Kosovës dhe Çeçenisë
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
USD	Valuta e Shteteve të Bashkuara - Dollari

Përmbledhje Ekzekutive

Përkundër nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit në vitin 2013, shumë banorë në veri të Kosovës vazhdojnë ta refuzojnë integrimin në Kosovë. Kosova mbetet e ndarë, si fizikisht ashtu dhe psikologjikisht, e ngarkuar me probleme të brendshme strukturore dhe sfida të jashtme. Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë i udhëhequr nga BE-ja perceptohet nga qytetarët e komuniteteve të ndryshme të Kosovës si një “kuti e zezë”, ku prapa dyerve të mbyllura imponohen zgjidhje gjysmake dhe jopraktike.

Ky hendek në mes të politikë-bërësve dhe qytetarëve ka shtyrë organizatën PAX dhe partnerët e projektit të përgatisin këtë raport, me qëllim që të diskutohet e ardhmja e mundshme për veriuin e Kosovës, të mblidhen rekomandimet e nxjerra nga diskutimet në nivel lokal dhe të nxiten diskutimet dhe mirëkuptimi në mes politikë-bërësve dhe qytetarëve. Rezultat i gjithë kësaj është ky raport i përbërë nga katër pjesë kryesore: rekomandimet, këndvështrimet nga terreni, skenarët si dhe shtytësit dhe çështjet kryesore.

Rekomandimet do t’iu dorëzohen ekipeve të dialogut, qeverive të Kosovës dhe Serbisë, komunitetit ndërkombëtar dhe komunave në veri të Kosovës. Aty përfshihen edhe rekomandimet e dala nga diskutimet me njerëzit në veri të Kosovës, të cilat u mbajtën gjatë përgatitjes dhe rishikimit të katër skenarëve për të ardhmen. Këto rekomandime kanë për qëllim të ndihmojnë në krijimin e rrethanave ku të gjitha komunitetet që jetojnë në veri të Kosovës, do ta shohin të ardhmen e tyre dhe të fëmijëve të tyre në Kosovë, duke iu falënderuar:

- ◆ përmirësimit të proceseve politike (ku përfshihet edhe më shumë transparencë dhe llogaridhënie);
- ◆ masave dhe sqarimeve që kanë të bëjnë me sistemin arsimor;

- ◆ masave që stimulojnë punësimin;
- ◆ përmirësimin të sundimit të ligjit; dhe
- ◆ masave për forcimin e besimit mes pjesëtarëve të komunitetit serb (përfshirë mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve të ndryshme në Kosovë).

Këndvështrimet nga terreni përfshijnë pikëpamjet e njerëzve nga veriu dhe jugu i Kosovës¹. Opinione të shprehura nga banorët e veriut të Kosovës tregojnë se ekziston një ndjenjë e fuqishme e izolimit dhe frustrimit me proceset politike, mungesë të shërbimeve elementare dhe papunësi. Frustrime të ngjashme konstatohen edhe në jugun e Kosovës.

Skenarët përshkruajnë katër variante të mundshme të së ardhmes së veriut të Kosovës. Këto nuk janë parashikime të sakta dhe e ardhmja e vërtetë me gjasë do të ketë elemente nga të katër skenarët.

- ◆ *Kali dhe uji:* sipas skenarit të parë, angazhimi i pamjaftueshëm i BE-së është një nga faktorët që kontribuon në mos jetësimin e Asociacionit të komunave serbe. Kjo, së bashku me papunësinë dhe frikën për të ardhmen, rezultojë me migrimin e shumë serbëve nga veriu i Kosovës në Serbi. Shqiptarët, në kërkim të pronave të lira, e plotësojnë vakumin e lënë nga serbët e larguar prej komunave veriore, që shpie në integrimin de facto të kësaj pjese të Kosovës. Mungesa e perspektivës së vërtetë për integrim në BE krijon hapësirë për radikalizmin islamik dhe krimin e organizuar. Sipas këtij skenari, veriu i Kosovës do të integrohet plotësisht me Kosovën deri në vitin 2020, por vetëm pak Serb do të mbeten për të jetuar aty.
- ◆ *Tranzicioni:* Sipas këtij skenari, angazhimi i vazhdueshëm dhe më i madh i BE-së dhe përmirësimi në marrëdhëniet në mes Serbisë dhe Kosovës rezultojnë me një marrëveshje gjithëpërfshirëse ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke përfshirë edhe marrëveshje për marrëdhëniet bilaterale dhe për të gjitha shërbimet publike në veriun e Kosovës. Në Prishtinë vjen në pushtet një gjeneratë e politikanëve të rinj, që e ndryshon mënyrën e qeverisjes, që rezulton, përveç tjerash, me përmirësimin e pozitës së komuniteteve pakicë. Liberalizimi i vizave dhe shkëmbimet në fushën e arsimit iu mundësojnë kosovarëve qasje të gjithanshme në botë. Krijohet Asociacioni i komunave serbe, që do të ketë autonomi në pesë fusha. Përpjekjet e përbashkëta të BE-së për ta luftuar krimin e organizuar kontribuojnë në përmirësimin e gjendjes në Kosovë. Kosova, duke përfshirë edhe veriun, do të përparojë në rrugën e saj drejt BE-së.
- ◆ *Qorrsoakaku dhe pranimi i gjendjes:* Sipas këtij skenari, banorët serb të Kosovës kaplohen nga gjendja e pashpresë, lodhja dhe apatia. Meqenëse Serbia merr vendime ekonomike jopopullore në përputhje me politikën për anëtarësim në BE, Kosova nuk është më çështje e rëndësishme në agjendën e Serbisë. Asociacioni i komunave serbe kurrë nuk jetësohet dhe ndërpriten subvencionet e Serbisë për veriun e Kosovës. Srpska bëhet një forcë politike autoktone, e cila përfaqëson serbët e Kosovës brenda sistemit politik. Ajo i përdorë votat e saj në Kuvendin e Kosovës për të negociuar masat që do të parandalonin çfarëdo ndryshimi dhe do ta mbanin veriun e Kosovës të ndarë.

Veriu i Kosovës vazhdon të mbetet, pak e shumë, një zonë gjysmë-autonome ku mungon sundimi i ligjit, nuk ka vende pune dhe më nuk është territor i kontestuar, por është i ndarë nga pjesa tjetër e Kosovës.

- ◆ *Relapsi - Kthimi në gjendjen paraprake:* Sipas këtij skenari, mungesa e ujit të pijshëm nxit protesta masive kundër qeverisë në Prishtinë, të cilat kthehen në trazira. Politikanët drejtojnë gishtin kah serbët që kontrollojnë liqenin e Gazivodës, kështu që zemërimi i publikut orientohet kundër serbëve, që ka për pasojë incidente të dhunshme ndëretnike. Forcat e reduktuara ushtarake të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Kosovë (KFOR) nuk kanë mundësi të veprojnë, ndërsa Policia e Kosovës shpartalohet dhe ndahet në baza etnike. Serbët ikin drejt veriut, shqiptarët drejt jugut. Serbia dërgon armë në veri të Kosovës me ndihmën ruse. Përfshirja e Rusisë e bën NATO-n që të ngurrojë për të intervenuar fuqishëm. Konflikti shkallëzohet drejt luftës civile dhe rrezikon të përhapet në tërë rajonin. Lumi Ibër bëhet vija kryesore e frontit, duke e ndarë veriun nga pjesa tjetër e vendit.

Pjesa e fundit e këtij raporti përbëhet nga dy pjesë, Shtytësit dhe Çështjet kryesore. Pjesa që flet për shtytësit përshkruan shtytësit e ndryshimeve politike, të sigurisë, ekonomike dhe socio-kulturore, deri në vitin 2020. Pjesa ku diskutohet për çështjet kryesore fokusohet në çështjet e rëndësishme me të cilat 'ushqehen' shtytësit në fushën e ujit, energjisë, arsimit, mjeteve të informimit dhe telekomunikacionit dhe industrisë së rëndë. ◆



Rruga kryesore në veri të Mitrovicës: Përveç të gjitha ndryshimeve politike, shumë Serbë në veri të Kosovës shpresojnë ti rrisin fëmijët dhe të jetojnë atje.

Rekomandimet

Rekomandimet e mëposhtme bazohen në dy supozime për aspektet e ardhmërisë së dëshiruar për veriun e Kosovës deri në vitin 2020: e para, që serbët janë në gjendje të jetojnë dhe t'i rrisin fëmijët e tyre pa frikë në Veriun e Kosovës dhe kanë arsye të jenë optimist për të ardhmen e tyre; dhe e dyta, se të gjitha komunitetet në Kosovë ia dalin të bashkëjetojnë, duke u respektuar të drejtat dhe mundësitë e barabarta për të gjithë. Rekomandimet e cituara më poshtë bazohen në atë se çka duhet ndryshuar, sipas mendimeve të pjesëmarrësve në projekt, në mënyrë që të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe pozitiv në veri të Kosovës.

Veprimet e menjëhershme

Për ekipet e dialogut:

- ◆ Nën patronazhin e Shërbimit European për Veprim të Jashtëm (EEAS), Kosova dhe Serbia duhet të **arrijnë marrëveshje për sistemin gjyqësor** dhe menjëherë të fillojnë implementimin e saj, për të ruajtur dhe fuqizuar efektet pozitive të integritetit të pjesëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë në Policinë e Kosovës.
- ◆ Kosova dhe Serbia, të përkrahura nga EEAS, duhet të pajtohen për zbatimin e ndonjë metode për **rritjen e transparencës dhe sqarimin** e procesit të dialogut, marrëveshjeve të arritura dhe mënyrës së implementimit të tyre. Përveç gjërave të tjera, ato duhet të krijojnë një uebfaqe në dy gjuhë, e cila do

të ofronte informata të plota rreth të gjitha marrëveshjeve; azhurnime dyjavore për punët e grupeve të ndryshme teknike dhe për procesin e implementimit të marrëveshjeve; dhe shpjegime të qarta në lidhje me ndikimet e këtyre zhvillimeve. Uebfaqja duhet të përmbajë sqarime për proceset e akreditimit të diplomave dhe implikimet e ligjit për amnistinë në bizneset e serbëve të Kosovës të regjistruara në Serbi.

Për Kosovën dhe Serbinë:

- ◆ Qeveria e Kosovës duhet të bëjë të ditur qëllimin e saj për të ndihmuar **rregullimin e varrezave ortodokse** në Komunën jugore të Mitrovicës. Ajo duhet të arrijë një marrëveshje me Kishën Ortodokse Serbe dhe Komunën Jugore të Mitrovicës dhe të ndajë fonde për ta zgjidhur këtë çështje. Gjestet e vullnetit të mirë janë të nevojshme për krijimin e besimit ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe popullatës serbe në veri.
- ◆ Qeveria e Kosovës dhe Misioni European për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) duhet të vazhdojnë të **investojnë në trajnimin e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës në veri të Kosovës** dhe t'i shfrytëzojnë më mirë programet e shkëmbimeve ndërkombëtare. Qeveria e Kosovës duhet t'i japë prioritet plotësimi të nevojave logjistike për t'i përmirësuar kushtet në Policinë e Kosovës dhe aftësitë e tyre për t'i zbatuar detyrat.
- ◆ Serbia duhet në mënyrë publike të shprehë **besimin dhe përkrahjen e saj të plotë për Policinë e Kosovës** me qëllim që ta ngrit legjitimitetin e saj.

Për bashkësinë ndërkombëtare:

- ◆ Përfaqësuesit e BE-së, në të gjitha nivelet, duhet të **bashkëveprojnë më intenzivisht me banorët** në veri të Kosovës. Bashkëveprimi duhet të bëhet jo vetëm me përfaqësuesit e zgjedhur ose liderët e përkohshëm, por gjithashtu edhe me qytetarët. Bashkëveprimi duhet të implementohet përmes formave të ndryshme siç janë: diskutimet publike, fokus grupet e mbyllura dhe përmes takimeve bilaterale.

Për komnatat në veri të Kosovës:

- ◆ Kryetarët e katër komunave në veri të Kosovës – ngjashëm si edhe Serbia - duhet të shprehin **besimin e tyre të plotë dhe t'i ofrojnë përkrahje Policisë së Kosovës**.
- ◆ Kuvendet komunale në veri të Kosovës duhet t'i bëjnë **publike mbledhjet e tyre** dhe të punojnë në mënyrë më të përgjegjshme dhe transparente.

Veprimet afat-shkurtra (0-2 vite)

Për ekipet e dialogut:

- ◆ Kosova, Serbia dhe EEAS duhet t'iu japin prioritet marrëveshjeve dhe sqarimit të tyre (**për t'i shmangur të gjitha pengesat për investime**), dhënies së kredive dhe iniciativave të biznesit në veri të Kosovës, përfshirë edhe dispozitave që rregullojnë tatimet dhe çështjet pronësore.
- ◆ Qeveria e Kosovës, EEAS dhe Serbia duhet bashkërisht t'i sqarojnë implikimet e marrëveshjeve të dialogut **në sistemin arsimor**. Kjo informatë duhet të bëhet publike si dhe t'iu shpërndahet të gjitha shkollave fillore, të mesme dhe universitetit të Mitrovicës. Informatat duhet të përshijnë garancitë e Bashkimit Europian që kanë të bëjnë me arsimin e pakicave, për ta zbutur frikën nga imponimi i plan-programeve arsimore të Kosovës.
- ◆ Kosova dhe Serbia, me ndihmën e EEAS, duhet të pajtohen për **vazhdimin e financimit** nga Serbia të njerëzve që punojnë në sektorin publik në veri të Kosovës. Nëse Serbia planifikon ta ndërpres financimin pas një kohe të caktuar, duhet krijuar një mekanizëm kalimtar për të kufizuar rënien e shpejtë të mjeteve për ekzistencë për banorët e veriut.
- ◆ Qeveritë e Kosovës dhe Serbisë, të ndihmuara nga EEAS dhe në konsultim me palët tjera me interes, duhet t'i definojnë dhe t'i **zgjidhin mosmarrëveshjet e mbetura që kanë të bëjnë me minierën e Trepçës**. Duhet të krijohet një strategji realiste, përmes një qasje hap-pas-hapi, për të arritur eksplotimin e minierave të Trepçës dhe rritjen e punësimit në rajon. Kjo strategji duhet të jetë publike.

Për Kosovën dhe Serbinë:

- ◆ Qeveria e Kosovës, me ndihmën e BE-së, duhet t'i intensivikojë bisedat me serbët e veriut mbi **kompetencat e Asociacionit së komunave serbe**. Këto biseda nuk duhet të kufizohen vetëm me liderët serbë, por duhet të përfshijnë edhe komunitetin në fjalë. Marrëveshjet e mëtejme në lidhje me Asociacionin e komunave serbe duhet të përfshijnë edhe një **mekanizëm të monitorimit** që do t'i mundësojë shoqërisë civile dhe bashkësisë ndërkombëtare të mbikëqyr fondet publike të cilat do të administrohen nga Asociacioni i komunave serbe.
- ◆ Të gjitha partitë politike në Kosovë duhet ta përkrahin **mbrojtjen e plotë të të drejtave të komuniteteve jo-shqiptare**; ky është një hap i nevojshëm për t'i siguruar serbët e veriut të Kosovës se ata kanë një të ardhme të qëndrueshme dhe të rikthejnë besimin te të gjitha komunitetet pakicë.
- ◆ Serbia duhet të **stimulojë vendimmarrjen e pavarur** të kryetarëve dhe kuvendeve të sapo zgjedhur në komunat veriore, gjë që do t'iu mundësojë atyre ta përfaqësojnë në mënyrë adekuate popullatën në veriun e Kosovës.

Për bashkësinë ndërkombëtare:

- ◆ NATO-ja **nuk duhet t'i zvogëlojë kapacitetet operacionale të KFOR-it** të paktën deri në vitin 2020. NATO-ja duhet **të sqarojë publikisht se çfarë garancish** i janë dhënë Qeverisë së Serbisë për të parandaluar qasjen e Forcave të armatosura të Kosovës në veriun e vendit dhe t'i zbusë shqetësimet e serbëve të Kosovës për sigurinë e tyre.
- ◆ Shtetet anëtare të BE-së duhet ta **zgjasin mandatin e EULEX-it** dhe ky mision duhet **të vazhdojë të ketë kompetenca ekzekutive** për çështjet si krimi i organizuar, krimet e luftës dhe krimet ndëretnike, të paktën deri në vitin 2020, kurse efektiviteti dhe efikasiteti i tij duhet të përmirësohet.
- ◆ EULEX-i duhet të bëjë më shumë përpjekje që të mos shihet si institucion i ndikuar politikisht dhe të sillt vetëm **si mbrojtës i pavarur dhe neutral** i ligjit.
- ◆ Donatorët ndërkombëtar duhet të **stimulojnë dhe investojnë në potencialin** e shoqërisë së veriut të Kosovës duke mbështetur gazetarinë hulumtuese dhe avokimin e shoqërisë civile si dhe duke shtuar numrin e programeve të shkëmbimit ndëretnik dhe ndërkombëtar. Fondacionet politike ndërkombëtare duhet të inkurajojnë dhe përkrahin krijimin e partive politike multietnike të grave në veri të Kosovës.
- ◆ Donatorët ndërkombëtar, në konsultim me autoritetet komunale në veri të Kosovës, duhet të **investojnë në projektet e infrastrukturës** që ta përmirësojnë menaxhimin e mbeturinave, menaxhimin e ujit dhe furnizimin me energji elektrike. Prioriteti duhet t'i jepet pastrimit të mbeturinave afër lumit Ibër në Komunën veriore të Mitrovicës dhe gjetjes së një deponie alternative për hedhjen e mbeturinave. Duhet të krijohet një mekanizëm i qartë mbikëqyrës për të gjitha projektet e infrastrukturës, ku do të përfshihen grupe të ndryshme nga shoqëria civile, me qëllim që të parandalohet keqpërdorimi i fondeve.
- ◆ BE-ja duhet t'i iniciojë debatet publike përmes mjeteve të informimit dhe takimeve publike, në **të cilat do të jepen shembuj** të ndryshëm të **garantimit të të drejtave të pakicave** nga shtetet e BE-së. Gjithashtu duhet të merren parasysh praktikat më të mira nga rajoni dhe duhet të inkurajohet harmonizimi i mekanizmave për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të pakicave në mes të shteteve në rajon (duke ndjekur shembujt më të mirë të konventave të Këshillit të Europës).

Veprimet afat-mesme (1–3 vite)

Për ekipet e dialogut:

- ◆ Kosova dhe Serbia, me ndihmën e EEAS, duhet të negociojnë për hartimin e kornizës që rregullon **statusin e gjitha shërbimeve publike të serbëve** në veri të Kosovës.

Për Kosovën dhe Serbinë:

- ◆ Qeveria e Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë nuk duhet t'i kufizojnë investimet e tyre të mëdha vetëm në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës. Ato gjithashtu duhet të **investojnë edhe në komunat jugore poshtë lumit Ibër**. Qeveria e Kosovës, e ndihmuar nga BE-ja dhe Serbia, duhet t'i nxisë kryetarët e të gjitha komunave të krijojnë një grup punues për zhvillim ekonomik, detyra e të cilit do të jetë hartimi i planit për mundësitë e ndërmarrësisë në tërë rajonin, ku do të përfshihet edhe ndihma për bizneset e vogla që ofrojnë punësim. Ky plan duhet të përfshijë edhe identifikimin e mundësive të reja dhe të ligjshme për zhvillimin e tregtisë nga jugu i Kosovës deri në Serbi, përmes veriut të Kosovës, dhe përkrahjen për bizneset e vogla që ofrojnë punësim.
- ◆ Ministritë e Arsimit të Kosovës dhe Serbisë duhet të hartojnë një **plan-program të përbashkët mësimor serbo-kosovar për lëndën e edukatës qytetare** dhe ta bëjnë këtë lëndë të detyrueshme në shkollat fillore të Kosovës dhe Serbisë, për fëmijët nga mosha shtatëvjeçare. Temat kryesore të kësaj lënde do të jenë mësimet për të drejtat e njeriut, korrupsionin dhe zbulimin e tij, bashkëpunimin ndëretnik, mirëkuptimin ndërkulturor, ndjeshmërinë dhe tolerancën.

Për bashkësinë ndërkombëtare:

- ◆ Donatorët ndërkombëtar duhet të ofrojnë mbështetje të gjerë dhe ekspertizë teknike për përmirësimin e **cilësisë së arsimit në Universitetin e Mitrovicës**, me qëllim që të joshen studentët për të studiuar në këtë universitet për shkak të cilësisë të mësimdhënies, e jo për shkak të dhënies së bursave.

Për komunën veriore të Mitrovicës:

- ◆ Komuna veriore e Mitrovicës, me ndihmën e përbashkët nga Qeveritë e Kosovës dhe Serbisë, duhet të organizojë **kurse jo të detyrueshme** për rininë, **për mësimin e gjuhës shqipe dhe serbe**, duke filluar nga lagjet shumëtnike, por ku mund të kenë qasje edhe banorët tjerë. ◆

1. Hyrje dhe Metodologjia

Ky raport shqyrton perspektivat e tashme të qytetarëve të veriut të Kosovës dhe të aktorëve tjerë, si dhe bën projektimin e rezultateve të mundshme të së ardhmes së veriut të Kosovës. Organizata PAX dhe partnerët e saj dëshirojnë që, përmes këtij publikimi, t'i kontribuojnë diskursit aktiv publik mes banorëve të veriut të Kosovës për proceset politike dhe të tërheq vëmendjen ndaj brengave të banorëve dhe rekomandimeve të tyre për politikë-bërësit (ndër)kombëtar, me qëllim të përmirësimit të gjendjes në këtë pjesë të Kosovës.

Që nga fillimi i dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja në mes Kosovës dhe Serbisë, në vitin 2011, e deri tek Marrëveshja e Brukselit, e arritur në prill të vitit 2013 (me të cilën Serbia dhe Kosova janë pajtuar për parimet që rregullojnë pozitën institucionale të veriut të Kosovës si pjesë e Kosovës) e më tutje, banorët e kësaj pjese të Kosovës janë ndjerë të përjashtuar dhe të injoruar. Edhe pse marrëveshja e arritur ndikon fuqishëm në jetën e njerëzve në veri të Kosovës, përfshirja e banorëve nga veriu i vendit në proceset politike ka qenë i vogël, gjë që ka shtuar frikën dhe armiqësinë e tyre ndaj marrëveshjes.

Përveç kësaj, Brukseli duket se vazhdon t'i perceptojë banorët e veriut të Kosovës si shkaktarë të trazirave, të cilët nuk mund ta pranojnë realitetin aktual. Hendeku në mes të marrëveshjes nga lart-poshtë dhe perspektivës së njerëzve të zakonshëm përbën dy sfida për paqen në veriun e Kosovës: e para, vendimet nga lart-poshtë mund të ngjallin indiferencë dhe rezistencë; e dyta, politikë-bërësit nuk janë të informuar sa duhet për brengat e njerëzve të zakonshëm në terren, që e rrezikon kualitetin e politikave të hartuara. Këto dy faktorë e pengojnë implementimin e marrëveshjes së arritur në prill të vitit 2013 dhe zhvillimin e një shoqërie demokratike në Kosovë.

1.1 Metodologjia

Analiza e së ardhmes së veriut të Kosovës kërkoi grumbullimin e informatave të shumta nga grupet e ndryshme (politike, të sigurisë, ekonomike dhe socio-kulturore)- jo vetëm që të krijojmë një ide se cili konsiderohet skenari më i mundshëm, por gjithashtu edhe të kuptojmë se çka është e pranueshme. Kjo nuk ishte punë e lehtë. Lufta e vitit 1999 shkatërroi jo vetëm pamjen fizike të Kosovës, por edhe strukturën e shoqërisë së saj në mënyra të ndryshme. Ngjashëm sikur objektet dhe infrastruktura e dëmtuar, e cila nuk është riparuar në 15 vitet e pas luftës, ashtu edhe marrëdhëniet dhe lidhjet mbeten të shkëputura. Ekziston mungesa e besimit, pohimet është vështirë të vërtetohen, ndërsa 'faktet' janë relative - varësisht nga këndvështrimi.

Në vjeshtën e vitit 2013, një grup prej tetë individësh, përfaqësues të partnerëve të projektit nga veriu dhe jugu i Mitrovicës dhe Holanda, u takuan në një sesion dy-ditor për t'i definuar shtytësit dhe drejtimet kryesore të matricës, përmes të cilave mund të krijohen skenarët. Shtytësit e identifikuar gjatë këtij sesioni paraqesin motorët kryesorë të ndryshimit, të cilët do të krijojnë ngjarje dhe do të ndikojnë në to deri në vitin 2020. Me kalimin e kohës shtytësit evoluojnë dhe paraqesin manifestime të forcave të brendshme kurse, në një masë më të vogël edhe të forcave të jashtme, të cilat formësojnë sjelljen e njerëzve dhe institucioneve. Pa dashur të paragjykojë efektet qoftë negative ose pozitive për njerëzit e veriut të Kosovës, grupi ka identifikuar katër shtytës kryesorë në secilën nga katër fushat themelore (politike, të sigurisë, ekonomike dhe socio-kulturore) që do të kenë ndikim të fuqishëm në të ardhmen e veriut të Kosovës. Matrica që krijon skenarët përbëhet prej një boshti kryesor i cili definohet si vazhdimësi e (jo)stabilitetit rajonal dhe tjetri si vazhdimësi e integritit të veriut të Kosovës me pjesën tjetër të vendit.

Shtytësit dhe boshtet krijuan bazën për përgatitjen e intervistave, të cilat u realizuan gjatë një periudhe dyjavore, në janar të 2014-ës, me ç'rast u intervistuan më shumë se 80 repondent, nga të cilët më shumë se gjysma ishin serbë, banorë të katër komunave në veri të Kosovës (Komuna veriore e Mitrovicës, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi). Grupet e respondentëve nga veriu ishin nga fusha e arsimit, shërbimit shëndetësor, mjeteve të informimit, sigurisë, menaxhimit të ujërave, menaxhimit të hedhurinave dhe biznesit; brenda tyre kishte edhe përfaqësues të grupeve rinore dhe grave.

Takime grupore gjithashtu u mbajtën me shqiptarët dhe komunitetet e tjera nga veriu dhe jugu i Mitrovicës. Me qëllim të mbledhjes së të dhënave u mbajt një takim tjetër grupor me përfaqësuesit e komunitetit serb nga pjesa qendrore e Kosovës. Këto takime janë plotësuar me intervista të realizuara me diplomatët ndërkombëtar, analistët dhe politikë-bërësit kosovar dhe serb në Prishtinë, Beograd dhe Mitrovicë. Qëllimi i mbledhjes së të dhënave ishte i dyfishtë: e para, të merren sa më shumë informata lidhur me mendimet, brengat dhe shpresat e njerëzve nga veriu, dhe e dyta, përfshirja e analizës së këtyre informatave si bazë për përgatitjen e skenarëve të së ardhmes së veriut të Kosovës. Intervistat janë realizuar sipas rregullave "Chatham House" për të ruajtur anonimitetin e të intervistuarve.

Analiza ka prodhuar katër narrativë të skenarëve të mundshëm apo 'histori të së ardhmes' së Kosovës dhe territorit të saj verior, deri në vitin 2020. Narrativët rezultuan nga bashkëveprimi ndërmjet shtytësve. Çdo narrativ tregohet nga perspektiva e vëzhguesit në vitin 2020, i cili kthehet prapa në ngjarjet e së kaluarës, për këtë arsye ato janë shkruar në kohën e shkuar. Në prill të vitit 2014, draft-skenarët janë diskutuar me 20 individë nga veriu i Kosovës dhe jugu i Mitrovicës, për të marrë opinionet dhe për t'i elaboruar rekomandimet bazë. Disa komponentë dhe rekomandime të narrativëve janë përshtatur, duke u bazuar në informatat e marra. Raporti i plotë është diskutuar gjerësisht me partnerët e projektit dhe është rishikuar nga analistët dhe diplomatët e huaj, të cilët nuk kanë qenë të përfshirë drejtpërdrejtë në këtë projekt. ♦

2. Këndvështrimi nga terreni

2.1 Nga veriu

Intervistat me grupe të ndryshme të njerëzve nga komuniteti serb i veriut të Kosovës sugjerojnë dy perspektiva kryesore të cilat janë formësuar në mesin e qytetarëve, e të cilat kanë ngjashmëri të madhe me njëra tjetrën. Perspektiva më e rëndësishme dhe më e përhapur është ndjenja e izolimit të plotë: Marrëveshja e Brukselit i ka nervozuar shumë serbë të Kosovës për shkak të asaj që ata e shohin si tradhti të vëllezërve të tyre në Serbi. Ata fillimisht kanë qenë të bindur se refuzimi i tyre ndaj integritit në institucionet e Kosovës do të përkrahet në mënyrë të palëkundur nga politikanët në Beograd, por oportunizmi politik dhe dykuptimësia e veprimeve të Serbisë për të arritur një marrëveshje me Kosovën, në mënyrë që asaj t'i hapet rruga drejt anëtarësimit në BE, ka bërë që të humbet besimi i komunitetit serb nga veriu i Kosovës në lidhshmërinë e shtetit Serb. Shumica e serbëve nga veriu i Kosovës asnjëherë nuk ka besuar në gatishmërinë apo aftësinë e Prishtinës (BE-së, SHBA-ve apo dikujt tjetër) që t'iu shërbejnë interesave të tyre, e as që kanë parë ndonjëherë vullnetin e vërtetë të Prishtinës për t'ia zgjatur dorën komunitetit serb përtej komunikimit të domosdoshëm. Prandaj, humbja e një burimi të avokimit (Serbia) në të cilin ata janë mbështetur deri më tani, është një goditje e hidhur.

Banorët shqiptarë në veri ndajnë të njëjtën ndjenjë të izolimit, por për arsye tjera: prezenca e tyre si pakicë brenda një territori ku shumicën e popullsisë e përbëjnë serbët, ka qenë gjithmonë disavantazh për ta nga aspekti i sigurisë. Megjithatë, tani serbët mund të frustrohen më lehtë për shkak të asaj që ata e shohin si braktisje nga Serbia, frustrim ky që ka ngjallur frikë mes shqiptarëve për shkak të reprezaljeve të mundshme ndaj tyre.

Rritja e pakënaqësisë të shqiptarët dhe serbët në veri shpjegohet me faktin se marrëveshjet që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në komunitetet në fjalë, janë krijuar nga elitat politike

të Serbisë, Kosovës dhe shteteve të huaja dhe janë futur në një “kuti të zezë”, pa marrë në konsideratë mendimet e komuniteteve përkatëse dhe pa çarë kokën shumë për mundësinë e implementimin praktik të marrëveshjeve. Kjo mospërfillje dhe mungesë e komunikimit të drejtpërdrejtë nga të gjithë aktorët, qofshin ata nga Beogradi, Brukseli apo Prishtina, ka ndikuar veçanërisht te banorët e komunitetit serb që të ndihen të pafuqishëm dhe të braktisur.

Izolimi, për të cilin ankohen serbët e veriut të Kosovës, ka krijuar një lloj jostabiliteti social i cili nxit një perspektivë të dytë: veriu i Kosovës nuk ka të ardhme të sigurt. Banorët e kësaj zone e shohin qeverisjen e korruptuar në Prishtinë si pengesën dhe fajtorin kryesor që edhe pas 15 viteve nuk mund t'i marrin shërbimet më themelore siç janë uji i pijshëm, menaxhimi adekuat i mbeturinave dhe furnizimi i pandërprerë me energji elektrike (duke mos përmendur këtu nevojat afatgjate për sistem gjyqësor funksional, shërbime shëndetësore dinjitoze, arsim kualitativ dhe siguri). Refuzimi i autoriteteve të Prishtinës vjen edhe për shkak të bindjes që mbretëron këtu sipas të cilës shumica e liderëve politik në Kosovë gjatë luftës kanë kryer krime ndaj serbëve dhe se ata dëshirojnë një Kosovë etnikisht të pastër - shqiptare.

Shumica e qytetarëve serbë nuk kanë asnjë njohuri për institucionet e Kosovës apo për kornizën e saj ligjore dhe kushtetuese. Kjo ndikon që mes serbëve të veriut të Kosovës të krijohen dy ide të kundërta: ideja e parë, të cilën e përmendin shumica e banorëve, është migrimi në Serbi. Kjo ide dominon posaçërisht në mesin e të rinjve, por edhe më të vjetrit dëshirojnë dhe planifikojnë një gjë të tillë për fëmijët e tyre, shumica e të cilëve dërgohen në Serbi për t'u arsimuar. Ideja e dytë është domosdoshmëria për t'u 'ulur galiç' dhe për të nxjerrë më të mirën nga situata e keqe. Ky qëndrim ka shumë më pak përkrahës në mesin e banorëve të veriut, por ka lindur nga ndjenja e fortë e përkatësisë dhe lidhjes së tyre me vendin. Banorët e veriut krenohen me qytetet e tyre dhe kanë dëshirë të qëndrojnë në to dhe të ndërtojnë një jetë më të mirë, qasje kjo e pranishme mes shoqërisë civile, e cila përpiqet që këtë edhe ta realizojë. Paradoksalisht, shumë nga ata që thonë se janë krenarë që janë autoktonë në Mitrovicë, qytetin më të madh në veri, e paraqesin atë si shembull të kosmopolitanizmit dhe bashkëpunimit ndëretnike në mes serbëve dhe shqiptarëve, edhe pse pak para kësaj kanë deklaruar se nuk dëshirojnë kurrë të bëhen miq me shqiptarët. Në veriun e Kosovës mungesa e besimit shkon deri në nivel të kontradiktave.

2.2 Nga jugu

Banorët e gjashtë komunave me shumicë serbe në jug të lumit Ibër, për dallim nga bashkëkombësit e tyre në veri të Kosovës, konsiderohen 'të integruar' në Kosovë. Këtë mendim e ndajnë si vëzhguesit e jashtëm ashtu dhe serbët që jetojnë në veri.

Megjithatë, intervistat me serbët në Graçanicë, qyteti kryesor serb në pjesën qendrore të Kosovës, tregojnë të kundërtën. Ata pretendojnë se kushtet e sigurisë për serbët që jetojnë në pjesën jugore të Kosovës janë të këqija dhe se serbët e këtyre vendbanimeve janë më të rrezikuar se sa bashkëkombësit e tyre në veri, dhe kjo për shkak se dominohen nga shumica shqiptare, në mesin e të cilëve akoma mbizotërojnë paragjykime ndaj pakicës serbe, të cilat reflektohen më së shumti në fushën e drejtësisë dhe zbatimit të ligjit. Në sytë e serbëve të Kosovës, serbët në veri kanë liri më të madhe të lëvizjes dhe siguri për shkak se atje jetojnë pak shqiptarë dhe nuk ballafaqohen me nivele të larta të armiqësisë sikur ata në jug. Ngjashëm sikur serbët në veri ashtu edhe bashkëkombësit e tyre në jug të lumit Ibër ndihen të izoluar brenda komunitetit të tyre, të pasigurt dhe kanë shumë mosbesim ndaj politikanëve, për të cilët thonë se më shumë kujdesen për xhepat

e tyre se për zgjidhjen e problemeve. Për këtë arsye, serbët në jug të Kosovë se mbështesin refuzimin e bashkëkombësve të tyre nga veriu për t'u integruar në sistemin kosovar. Ata janë të brengosur që integrimi i tyre ka rezultuar me fare pak përmirësime dhe konstatojnë se partitë politike të shqiptarëve të Kosovës veprojnë në favor të komunitetit serb vetëm pas presioneve të mëdha ndërkombëtare.

Serbët gjithandej ballafaqohen me vështirësi të njëjta. Mungesa e punësimit, sundimi i dobët i ligjit, arsimit jo kualitativ dhe shërbimet e dobëta shëndetësore e ndërlikojnë gjendjen e komuniteteve në veri dhe jug. Sidoqoftë, edhe shqiptarët gjithkund në Kosovë nuk janë imunë ndaj këtyre problemeve (serbët në jug e pranojnë se mungesa e sigurisë për shkak të kriminalitetit dhe shërbimet e dobëta shëndetësore janë probleme me të cilat ballafaqohen të gjitha grupet etnike).

Në intervistat e bëra me shqiptarët e Komunës jugore të Mitrovicës dhe Prishtinës hasen ankesa të ngjashme me ato të ngritura nga komuniteti serb. Korrupsioni, krimi dhe keqësimi i kushteve të jetesës janë probleme të prekshme si për respondentët shqiptarë ashtu edhe at serbë. Ngjashëm sikur serbët edhe banorët shqiptarë ankohen për sigurinë e pamjaftueshme, mungesën e shkollimit cilësor dhe përkujdesjes shëndetësore, infrastrukturën e shkatërruar (e cila nuk është riparuar që 15 vite) dhe krimin e organizuar, i cili mundëson vazhdimin e kësaj situatë. Një banor shqiptar nga Komuna jugore e Mitrovicës e shpjegon problemin në këtë mënyrë: "Këtu, krimi i organizuar fshihet prapa patriotizmit."

Shqiptarët, sikur edhe serbët, e shohin krimin e organizuar dhe korrupsionin në Kosovë si pengesë për zhvillimin ekonomik, kthimin e pronave dhe në transformimin e institucioneve të udhëhequra nga serbët, të cilat u krijuan pas lufte. Dhe, njëjtë sikur edhe serbët, shqiptarët janë të mendimit se vendimet që ndikojnë në jetën e tyre merren nga politikanët të cilët nuk konsultohen me komunitetin e prekur dhe nuk përgatisin marrëveshje që do të mundësonin implementimin e tyre në praktikë. Shumë shqiptarë thonë se bashkësia ndërkombëtare dhe Serbia bartin një pjesë të madhe të fajit për gjendjen e tanishme dhe në mbështetje të këtij pohimi përmendin çështjet si: mosnjohja e Kosovës nga pesë vendet anëtare të BE-së, mos-liberalizimi i vizave, mos-efikasiteti dhe degradimi i Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ndikimi dhe kontrolli i EULEX-it dhe kontrolli serb mbi veriun e Kosovës. Ata shprehin mos-durim me pakicën serbe dhe nuk u pëlqen ajo që e përshkruajnë si kërkesa të vazhdueshme dhe gjithnjë në rritje të serbëve të Kosovës, Serbisë dhe bashkësisë ndërkombëtare. Shqiptarët kanë përshtypjen se Qeveria e Kosovës po detyrohet të bëjë lëshime ndaj Serbisë dhe serbëve dhe se ata përfitojnë fare pak nga këto lëshime. Në Kosovë është shumë i shprehur mosbesimi dhe mosaprovimi për procesin e dialogut dhe rezultatet e tij.

Shqiptarët e shohin problemin e shërbimeve themelore - të cilat mungojnë si për qytetarët e jugut ashtu edhe ata të veriut - nga një këndvështrim më ndryshe se shumica e serbëve, të cilët mungesën e këtyre shërbimeve e konsiderojnë si çështje etnike dhe gjeografike. Një shqiptar i intervistuar deklaroi: "Kur ta zgjidhim problemin e furnizimit me ujë dhe rrymë, nuk do të ketë të privilegjuar. Të gjithë kemi nevojë për ato".

Një karakteristikë që doli nga intervistat me shqiptarët është vetëdijesimi i tyre se dallimet gjuhësore dhe mjetet e informimit janë faktorë që i kontribuojnë ndarjes së dy komuniteteve. Mungesa e informacioneve objektive në mediat në gjuhë serbe dhe shqipe, të cilave qytetarët mund t'iu besojnë, vazhdon të jetë prezent. Shqiptarët besojnë se mediat në gjuhën serbe krijohen dhe financohen nga Beogradi. Ekziston shkëmbimi i mirë i informatave në nivele

joformale ndërmjet gazetarëve shqiptarë dhe atyre serbë; megjithatë, në momentin kur informatat joformale duhet të bëhen zyrtare, këto marrëdhënie 'vëllazërore' ndërpriten. Kërcënimet kundër bashkëpunimit ndëretnik nuk janë të rralla.

E gjithë kjo shpie në një pikë kritike ku mungesa e informacionit objektiv dhe të verifikueshëm paraqet shkakun e qarkut vicioz të mosbesimit ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, të cilët thjesht shfaqin të njëjtën frikë dhe kanë të njëjtat ankesa. Nuk ekzistojnë kanale të pavarura dhe të besueshme jopartiake ku do të mund të shkëmbehen faktet dhe të prezantohen ngjarjet në mënyrë të papenguar, nga të cilët do të përfitonin të dy komunitetet. Në situatën e tanishme fare lehtë mund të manipulohet me të dyja palët, duke e drejtuar njërin kundër tjetrës dhe duke i mbajtur ato në errësirë, në gjendjen e status quos-së, e cila kontribuon që plagët të acarohen kurse mosbesimi të rritet. ♦

Një perspektivë e gjerë për Ballkanin

Dy shtetet shumetnike në rajonin e Ballkanit Perëndimor, Bosnjë Hercegovina dhe Maqedonia, vazhdojnë të ballafaqohen me ndasi etnike dhe fetare; integrimi i këtyre ndasive në politikë mbetet një pengesë e madhe për progresin e këtyre dy vendeve. Adresimi i të drejtave të të gjitha grupeve etnike është e rëndësishme për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në këto dy shtete.

Strukturat politike të krijuara nga Marrëveshja e Dejtonit në Bosnjë dhe Marrëveshja e Ohrit në Maqedoni e kanë vërtetuar ndarjen etnike. Këto marrëveshje më shumë kanë pasur për qëllim përfundimin e konfliktit se sa të shërbejnë si formula të qëndrueshme për qeverisje. Megjithatë, ky ishte fati i tyre. Marrëveshjet në fjalë nuk ndihmuan në tejkalimin afatgjatë të ndasive etnike e as nuk siguruan ndonjë formë të qeverisjes së mirë apo zhvillim inkluziv demokratik dhe ekonomik. Në kontekstin e gjerë rajonal, dhe kjo vlen në veçanti për Kosovën, këto marrëveshje duhet të shërbejnë si mësim nga të cilat duhet mësuar; vetëm duke nxjerrë mësim nga këto shembuj mund të ndërtohet një kornizë në të cilën të gjitha komunitetet mund t'i ushtrojnë lirisht të drejtat e tyre, të ndihen të mbrojtura dhe të përfaqësuara në strukturat shtetërore dhe të detyrohen strukturat e shtetit të fokusohen në përmirësimin e jetës së të gjithë qytetarëve.

Integrimi në Bashkimin Europian mbetet me rëndësi thelbësore për prosperitetin afatgjatë të popullit të rajonit. Kohezioni i brendshëm në Bosnjë Hercegovinë dhe Maqedoni është në rrezik. Megjithatë, ndryshimi i kohezionit të brendshëm në shkëmbim të anëtarësimit në Bashkimin Europian e rrezikon stabilitetin dhe prosperitetin e përgjithshëm rajonal. Trazirat e kohëve të fundit në Bosnjë (2014) janë shprehje e frustrimit të popullsisë me zhvillimin dhe stabilitetin ekonomik, brenda një demokracie shumetnike. Nëse qëndrimet e kandidatëve potencial për zgjedhjet e ardhshme në Bosnjë, në tetor 2014, mbeten të prangosur në të kaluarën, rajoni mund të ballafaqohet me një cikël tjetër të trazirave publike dhe konflikte në një periudhë afat-mesme. ♦


3. Skenarët

Pjesa në vijim përmban katër skenarë të mundshëm apo 'histori të së ardhmes' mbi zhvillimet në veriun e R Kosovës dhe rajonin përreth, deri në vitin 2020. Skenarët janë konstruktuar në bazë të informatave të grumbulluara nga intervistat dhe hulumtimet në terren dhe nga zyra. Këto storie të së ardhmes rezultojnë nga bashkëveprimi në mes shtytësve, aktorëve dhe çështjeve kryesore (shtytësit dhe çështjet kryesore janë shtjelluar në mënyrë të detajuar më vonë në këtë raport). Skenarët janë nxjerrë nga korniza e matricës (e paraqitur në Matriksin e skenareve në faqe 25) në të cilën trajektorja e integritit të brendshëm lëviz në drejtim të kundërt nga drejtimi i stabilitetit rajonal.

Skenarët nuk janë parashikime të sakta; ato më shumë kanë për qëllim të ofrojnë këndvështrime alternative në lidhje me rezultatet të cilat, kur mblidhen së bashku, ndihmojnë në krijimin e diçkaje që është e përafërt me perspektivën 360 shkallësh për të ardhmen e veriut të Kosovës. Nga këndvështrimi i sotshëm për secilin skenar mund të thuhet se ekziston një probabilitet më i lartë ose më i ulët i besueshmërisë. E ardhmja reale ndoshta do të përmbajë elemente nga të gjithë skenarët, të cilat janë treguar nga këndvështrimi i një vëzhguesi në vitin 2020, i cili shikon ngjarjet në retrospektivë që çojnë në një pikë të caktuar kohore në të kaluarën (prandaj edhe narrativët përdorin kohën e shkuar).

Veriu i Kosovës 2020
forma e skenareve:

Skema e pasigurisë kyçe të integritimit të veriut të Kosovës kundrejt shkallës së stabilitetit vendimtar rajonal



Integrimi faktik me prezencën e krimit dhe fundamentalizmit

Veriu i Kosovës 2020: Lëvizja drejt integrimit të brendshëm pasi rajoni përjeton ulje të stabilitetit

Dinamika e brendshme

Qartësia e pamjaftueshme rreth asociacionit dhe marrëveshjes nxit migrimin e serbëve nga veriu i Kosovës = Fillimi i ri-integrimit faktik pasi shqiptarët plotësojnë vakumin

Dinamika rajonale

Ekzekutivi i EULEX-it efektivisht merr fund; presionet buxhetore zvogëlojnë praninë e KFOR-it; Zvogëlohet radikalizmi dhe përshpejtohet ri-integrimi, Prishtina kërkon ndihmë nga Shqipëria

Poliitikë

Bisedat rreth "SHqipërisë së madhe" shfaqen politikisht, duke krijuar rreze të përhapura që mund të nxisin ndërhyrje të BE-së dhe SHBA-së derisa ftesa ndaj Serbisë për kandidaturë në be shtyhet

Ë sigurisë

Detyrimi i ndërtimit të Forcave të armatosura të Kosovës nga Prishtina për të luftuar "Elementet e krimit" përkundër kundërshtimeve të NATO-së; Furnizimi i armëve të palejuara nga krimi i armëve të palejuara nga krimi i organizuar; forcat policore të Kosovës ende pa kapacitetin të ndjekin krimet më serioze

Ekonomik

Forcat e krimit të organizuar dhe presionet kundër pastrimit të parasë detyrojnë bankat globale të tërhiqen; ekonomitë joligjore rriten nga bashkëpunimi i Shqipërisë dhe Maqedonisë

Socio-Kulturor

Kultura Shqiptare bëhet forcë shumë më e fortë por elementet fundamentaliste kërcënojnë të ndërpresin atë që ata e shohin si korruptim i besimit

Çrëteristikat e skenarit:

- ◆ Pa lidhshmëri të efektshme nga Prishtina, Beogradi apo BE-ja, asociacioni i komunave serbe do të dështojë në materializimin e saj të plotë, duke nxitur ekzodin më të madh të serbëve nga veriu dhe jugu i Kosovës
- ◆ Me përshpejtimin e zbrazjes së Serbëve nga veriu i Kosovës, komuniteti shqiptar bën përpjekje të ri-ndërtohet; partneriteti do të kërkohet në Shqipëri dhe Maqedoni
- ◆ Rritja e dukshme e bandave Shqiptare në punët e biznesit të korruptuar
- ◆ Ngritja e kritikave nga klerikët Vehabist; partitë politike fetare ngrisin më shumë zërin

3.1 Skenari Një: Ҙali dhe uji

Ajo që filloi si migrim i ngadalshëm por i vazhdueshëm i serbëve të veriut të Kosovës drejt Serbisë, në fillim të vitit 2010, u intensifikua deri në vitin 2020. Përkundër pritjeve pozitive pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit, rënia graduale e rolit të Europës në ndërmjetësimin e procesit të normalizimit të raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë e bllokoj ecjen përpara. Sipas vëzhguesve të ndryshëm, mosgatishmërinë e serbëve të veriut të Kosovës që ta pranojnë qeverisjen kosovare, përkundër presionit të kombinuar të Prishtinës, Serbisë dhe Bashkimit European, të rikujton fjalën e urtë: “Mund ta dërgosh kalin të uji, por nuk mund ta detyrosh atë të pijë ujë”.

Dykuptimësia e Marrëveshjes së Brukselit dhe mungesa e një udhërrëfyese të fuqishëm të BE-së krijoi mosmarrëveshje të vazhdueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe la zbrazëtira në interpretimin e kompetencave ligjore, çështjet që lidhen me arsimin dhe çështjet pronësore, që e bëri të pamundur zbatimin e plotë të marrëveshjes. Këto paqartësi bënë që të rritet ndjenja e braktisjes mes serbëve të Kosovës, veçanërisht pasi EULEX-i dhe KFOR-i publikuan planin për largimin e tyre. E ardhmja dukej e zymtë, ndërsa investitorët vazhdonin ta shmangin këtë zonë për shkak se sundimi i ligjit ishte i dobët dhe rregullat për të bërë biznes ishin të paqarta. Kjo gjendje ndikoi në rritjen e papunësisë në veri në një nivel rekord. Policia e Kosovës nuk ishte në gjendje të shfrytëzonte rritjen e legjitimitetit të saj, kurse për shkak të rrethanave të krijuara shumica e pjesëtarëve të Ministrisë së Brendshme të Serbisë të cilët iu bashkuan Policisë së Kosovës kishin aplikuar për punë në Serbi, duke e keqësuar situatën e sigurisë për serbët e Kosovës. Të ballafaquar me rritjen e kërcënimeve ndaj sigurisë së tyre për shkak të krijimit të Forcave të armatosura të Kosovës, serbët filluan ta lëshojnë vendin në numër shumë më të madh se në të kaluarën.

Mundësitë e punësimit në Serbi gjithashtu ishin të vogla: përparimi i saj drejt anëtarësimit në BE ishte ngadalësuar për shkak të lodhjes së shteteve anëtare të BE-së me procesin e zgjerimit, por edhe për shkak të pamundësisë së shtetit për t'i plotësuar standardet e BE-së. Si rezultat i kësaj, u forcuan zërat në politikë që bënin thirrje për krijimin e aleancave alternative me Rusinë.

Zbrazja e enklavave serbe i nxitu shqiptarët të migrojnë në veri, të tërhequr nga çmimet e ulëta të pronave. Depërtimi i vazhdueshëm i shqiptarëve në veri dhe në komunat jugore me shumicë serbe, që u përshpejtua nga viti 2015 e më pas, u mundësoi atyre të vendosin ad hoc tezat e tregut të zi dhe të krijojnë ndërmarrjet e vogla. Ky migrim revers krijoi fakt një formë pasive të re-integrimit të brendshëm, e cila dalëngadalë e lidhi rajonin e veriut me jugun: shumica e serbëve të mbetur në Kosovë ose ishin shumë të moshuar ose shumë të varfër për t'u larguar dhe për pasojë nuk ishin në gjendje që ta kundërshtojnë në mënyrë aktive imponimin e shtetësisë së Prishtinës ndaj komunitetit të tyre.

Dy elemente të komplikuar dhe acaruese që ndikuan në trendet e migrimit ishin krimi i organizuar dhe fundamentalizmi islamik - dy faktorë që çuan drejt përplasjeve të vogla e të izoluar ndëretnike, të cilat e shpejtuan largimin e individëve dhe familjeve të komunitetit serb. Në Prishtinë jeta vazhdoi e pandryshuar në stilin ‘biznes si zakonisht’ edhe pse aktorët kryesorë politik ishin ndryshuar në zgjedhjet e viteve 2014 dhe 2018, në skenën politike të Kosovës mbetën të njëjtat fraksione dhe interesa politike. Sundimi i ligjit mbeti sfida kryesore. Përparimi i kufizuar i Prishtinës në plotësimin e standardeve të BE-së, së bashku me realitetin politik të fragmentuar dhe një BE euro-skeptike dhe vazhdimi i kontestit me Serbinë i la shumë qytetarë të Kosovës të pashpresë

për prosperitet personal. Një numër gjithnjë në rritje i të rinjve të papunë nga zonat e varfra rurale jashtë Prishtinës përqaftuan format më radikale të islamit. Politikanët në Prishtinë, në përpjekje për të ofruar një alternativë të besueshme, i shfrytëzuan trendet demografike dhe filluan bisedat për krijimin e 'Shqipërisë së Madhe' e cila ndikoi në vazhdimin e destabilizimit rajonal.

Rrjetet shqiptare të krimit të organizuar, që tashmë ishin infiltruar brenda qeverisë së Kosovës, nuk pengoheshin më nga mandati ekzekutiv i EULEX-it. Këto rrjete u forcuan dhe u zgjeruan përtej kufijve kombëtar, që imponoi një angazhim të madh të Policisë së Kosovës për të ruajtur sigurinë e brendshme. Për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm për të ngritur një forcë të plotë ushtarake, diskutimet rreth aleancës së Kosovës me Shqipërinë dhe Maqedoninë e alarmuan Serbinë dhe i ngritën tensionet në Maqedoni dhe në jug të Serbisë. Në ndërkohë, grupet fundamentaliste islamike, e sfiduan sekularizmin kushtetues, si brenda ashtu edhe jashtë parlamentit, duke e refuzuar idenë e Shqipërisë së Madhe dhe kështu kërcënuan integritetin e brishtë të Kosovës. Kjo e detyron Prishtinën që në mënyrë më urgjente të kërkojë përkrahje nga Shqipëria.

Rreziku për destabilizimin rajonal nxiti intervenimin diplomatik jo entuziast nga SHBA-të dhe BE-ja, me qëllim që të forconin zbatimin e ligjit dhe kapacitetet e mbrojtjes dhe ta zvogëlonin rrezikun për përhapjen e paqëndrueshmërisë. Sidoqoftë, në fund të dekadës, këto gjeste u panë si ndërhyrje të padëshiruara dhe hasën në armiqësi dhe rezistencë të fortë. Fundi i dekadës së dytë pas luftës e gjeti Kosovën dhe Ballkanin duke u lëkundur në kushte të paqëndrueshme, ku gjetën strehë vetëm krimi dhe radikalizmi, dhe zhbënë të gjitha përpjekjet për ta bërë Kosovën një vend shumetnik, ku vetëm një pjesë e vogël e komunitetit serb mbeti e paprekur deri në vitin 2020.



Një shikim mbi veriun e Mitrovicës: Integrimi i veriut së bashku me jo-stabilitetin në rajon mund të çojë vetëm një pjesë e komunitetit Serb të qëndrojnë në Kosovë.

Një BE e ri-fuqizuar bën presion për qartësi dhe fuqizon shtetin ligjor

Veriu i Kosovës 2020: Lëvizja drejt integritit të brendshëm pasi rajoni përjeton një rritje të stabilitetit

Dinamika e brendshme	Presioni publik detyron leadershipin e Prishtinës dhe BE-së ti përshpejtojnë përpjekjet për liberalizimin e vizave; shteti ligjor rritet me qëndrueshmëri me misionin e përmirësuar të EULEX-it
Dinamika rajonale	Institucionet serbe mbyllen; Kosova dhe Serbia i zgjidhin çështjet juridike gjër në vitin 2020; Bosnia mbetet në gjendje ende të tensionuar por nuk dezintegrohet derisa Serbia fokusohet në kandidaturën e BE-së
Politikë	Të ngopur nga elita e vjetër, liderët e rinj dhe karizmatik Serb dhe Shqiptar dalin në shesh dhe bashkohen në Kosovë; gratë bëhen më shumë prezente në skenën politike
Ë siguri	BE-ja zhvillon qasje të re ndaj krimit transnacional, duke u lejuar forcave të brendshme të sigurisë së Kosovës hapësirë të përmirësohen. edhe pse krimi transnacional përbën ende kërcënim
Ekonomik	Balancimi i tregtisë përmirësohet vetëm pak ; eksporti ende mbështetet në industrinë e rëndë por inovacionet teknike fillojnë të ngriten nga viti 2020; ekonomia ende e ngadaltë
Socio-Kulturor	Një ndjenjë e përgjegjësisë së përbashkët për zhvillimin ekonomik dhe kualitetin e jetës e ngrit urejtjen; të rinjtë i drejtohen teknologjisë për ti përmirësuar ngecjet e tyre

Ëarakteristikat e skenarit:

- ◆ Arritja e marrëveshjes për marrëdhëniet Kosovë-Serbi; formohet Asociacioni i Komunave Serbe
- ◆ EULEX-i e përmirëson misionin e saj ku Gjermania involvohet më shumë në përkrahjen e përshpejtimit të qartësive rreth standardeve të Kosovës, në shtetin ligjor dhe juridiksionet
- ◆ Ëberalizimi i vizave do të lejon valët e para të udhëtarëve drejt shkëmbimit të arsimimit
- ◆ Një shkëmbim përvojash i llojit 'Baltik-Ballkan' fuqizon iniciativën arsimore duke u shoqëruar me një ri-modelim të opsioneve profesionale për rininë Shqiptare dhe Serbe; kjo shënon fillimin e politikave të bashkimit në mes një grupi të të rinjëve
- ◆ Grupet e bashkuara të grave në veri gjithashtu merren me sfidat politike

3.2 Skenari Dy: Tranzicioni

Në pesë vitet që i paraprinë vitit 2020 ndodhën një mal me ndryshime në veriun e Kosovës. Derisa jeta e përditshme në veri të lumit Ibër nga aspekti psikologjik mbeti e izoluar nga jugu dhe i lidhur ngushtë me Serbinë, në aspektin institucional, veri i Kosovës gradualisht u bë pjesë e Kosovës. Kjo ndodhi përmes zbatimit të ligjeve të Kosovës dhe fillimit të bashkëpunimit të institucioneve nga komunat veriore me Prishtinën, me përkrahjen formale të Beogradit.

Efektet e përhapjes së krizës së Ukrainës në vitin 2014 e motivuan BE-në që ta kontrollojë jo stabilitetin në Evropën Lindore. Dialogu Prishtinë-Beograd vazhdoi me ndërmjetësimin e BE-së në nivel të lartë, ku u adresuan disa çështje të mbetura që kishin të bëjnë me komunitetin serb në Kosovë dhe marrëdhëniet bilaterale. Në kuadër të këtij procesi, në të cilin BE-ja vendosi publikisht kushtet e qarta dhe rriti presionin ndaj të dy qeverive, Kosova dhe Serbia kaluan nga diskutimi rreth detajeve në gjetjen e zgjidhjeve për shqetësimet e serbëve në Kosovë. Kjo çoi në arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, e cila mundësoi vendosjen e marrëdhënieve bilaterale dhe krijoi një kornizë të qartë për të gjitha shërbimet publike të serbëve në veriun e Kosovës.

Një qasje më aktive e politikës së jashtme të Gjermanisë e detyroi BE-në që ta rrisë presionin por edhe ta qartësojë pozitën e saj. Meqenëse EULEX-i ishte i detyruar të zvogëlojë buxhetin dhe personelin e tij, nga ky institucion u kërkua që të bëjë më shumë (punë) me më pak (mjete). Kjo i mundësoi BE-së të marrë një qasje më të ashpër, me ç'rast nga Prishtina dhe Beogradi u kërkua t'i plotësojnë standardet dhe të dërgojnë porosi të qartë dhe konsistente për publikun. Serbia mbeti e fokusuar në anëtarësimin e saj në BE dhe bëri përparime në këtë drejtim. BE-ja dhe EULEX-i u përfshin më intenzivisht me liderët dhe banorët e veriut të Kosovës për t'i diskutuar politikatat dhe për t'ua qartësuar ato njerëzve në terren, duke krijuar kushte për bashkëpunim më të afërt dhe implementimin e ndryshimeve, të cilat ngadalë filluan t'i plotësojnë nevojat e publikut.

Pakënaqësia dhe protestat e shqiptarëve të Kosovës kundër korrupsionit, papunësisë dhe mungesës së zhvillimit ekonomik rezultuan me presion të mjaftueshëm të publikut që ndikoi në përmirësimin e sundimit të ligjit. Përpjekjet kundër korrupsionit, të frymëzuara nga mandatet rregulluese të imponuara në nivel global në fushat financiare dhe të sektorëve të sigurisë, i mundësuan EULEX-it të vazhdojë në mënyrë më energjike me arrestime në nivele të larta dhe ndjekjen penale të të akuzuarve për krime të luftës, korrupsionin dhe krim të organizuar. Këtë proces e ndihmoi një gjeneratë e liderëve të pasluftës të cilët filluan të vijnë në pushtet në Prishtinë deri në vitin 2018. Përmes përkrahjes popullore nga qytetarët e Kosovës të frustruar një kohë të gjatë, këta politikanë sollën transparencën dhe përfshirjen e publikut, kurse sukseset e arritura iu ndihmuan në zbutjen e mosbesimit dhe vendosjen e bashkëpunimit më të mirë me BE-në.

Një nga faktorët që ndihmoi suksesin e BE-së në Ballkan ishte azhurnim simultan i qasjes së saj ndaj krimit ndërkombëtarë. Evropa ishte përfshirë në betejë të cilën ajo nuk mund ta fitonte, betejën kundër sindikatave të krimit, të cilat po bëheshin gjithnjë e më të sofistikuara, gjë që e detyroi atë ta modernizojë Konventën e vjetërsuar të Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (UNTOC), me ç'rast u bën përkufizime të qarta ligjore, kurse INTERPOL-it iu dhanë fuqi më të mëdha sanksionuese dhe shfrytëzimin e iniciativave të reja teknike hartografike. Falë luftës kundër kriminalitetit dhe korrupsionit të zhvilluar në nivele europiane, ngadalë por sigurt, përmirësimi i gjendjes filloi të hetohet edhe në Kosovë.

Përparimi në sundimin e ligjit deri në vitin 2020, edhe pse me probleme në disa fusha, gradualisht

i përmirësoi kushtet për të gjitha komunitetet në jug, që ndikoi në rritjen e besimit mes serbëve në veri. Integrimi gradual i pjesëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë në Policinë e Kosovës dhe bashkëpunimi në mes Kosovës dhe EULEX-it, si pjesë e fushatës për forcimin e besimit, e kombinuar me masa energjike kundër krimit, shënoi fillimin e zgjidhje së problemit të mosndëshkimit në veri. Kthimi i pronave dhe gjykatat e avancuara me kompetenca të qarta ligjor, teknologjitë në dispozicion, si për shembull programi për përkthime universale, ndihmuan që përfshirja shumetnike të jetë më lehtë për t'u arritur se sa në dekadën e kaluar.

Kultura politike e Kosovës ishte pjekur në masë të vogël: përmirësimi i aftësive të Prishtinës për t'i plotësuar standardet e BE-së dhe normalizimi i vazhdueshëm i marrëdhënieve Serbi-Kosovë, i bindi shtetet anëtare të BE-së që nuk e kishin njohur Kosovën që së paku ta mbështesin liberalizimin e vizave. Edhe pse perspektiva ekonomike për rininë e Kosovës nuk ishte e mirë, hapja kufijve e zvogëloi ndjenjën permanente të izolimit dhe hapi mundësi të reja për shkollim. BE-ja inicioi programin e shkëmbimeve mes shteteve Baltike dhe Ballkanit, të njohur si "Shkëmbimet Baltiko-Ballkanike", që parashihte sjelljen e sipërmarrësve të suksesshëm nga Letonia dhe Estonia që të ndihmonin në përgatitjen e shkollimit profesional, shumë të nevojshëm në Kosovë. Duke shfrytëzuar përvojën e tranzicionit të shteteve Baltike nga ekonomitë e dobëta ish-komuniste në liderë të shkollimit teknik mbi sipërmarrësitë, u tentua të silllet dhe të aplikohet në sistemin e shkollimit profesional të Kosovës fokusimi në inovacionet e teknologjisë së ulët (loe-tech). Ndonëse programi u zhvillua ngadalë, ideja për këto programe të reja shërbeu si trampolinë për fillimin e bashkëpunimit ndëretnik, duke tërhequr disa të rinj drejt pjesëmarrjes aktive në politikë. Shkëmbimi gjithashtu rezultoi me krijimin e një iniciative të të rinjve për të tejkaluar segregacionin: gratë e reja nga komunitetet e ndryshme që jetonin në Mitrovicë i bashkuan forcat dhe iniciuan krijimin e një parti politike multietnike lokale. Këto iniciativa u panë me mosbesim nga pjesëtarët e komuniteteve të tyre.

Diskutimet në mes përfaqësuesve nga veriu i Kosovës, Prishtina, Beogradi dhe BE-ja për përfshirjen e komunitetit serb rezultuan me krijimin e Asociacionit të komunave serbe me autonomi në fushën e arsimit, shëndetësisë, zhvillimit ekonomik dhe në planifikimin urban e rural. Pas shqetësimit që shprehën organizatat e shoqërisë civile në lidhje me transparencën e Asociacionit të komunave, u krijua një mekanizëm monitorues për llogaridhënie formale, i cili ishte në shërbim si të anëtarëve të kuvendit komunal ashtu edhe opinionit publik dhe njëkohësisht mundësoi mbikëqyrjen ndërkombëtare të fondeve publike të administruara përmes Asociacionit të komunave serbe. Arsimi dhe shërbimi shëndetësor vazhduan të funksionojnë sipas sistemit serb, por harmonizimi i tyre me standardet e BE-së bëri që këto dy sisteme arsimore të jenë më pranë njëri tjetrit, çka mundësoi që shkollat serbe dhe kosovare të përdorin të njëjtën kurrikulë për edukatën qytetare.

Rritja ekonomike vazhdoi të jetë e ngadalshme; sidoqoftë, teknologjitë e reja e bënë më të lehtë për Kosovën të ballafaqohet me problemet në energjetikë dhe menaxhimin e ujit dhe mbeturinave, kështu që në fund të dekadës u shfaqën shenjat e para të përmirësimit të ekonomisë. Kosova filloi të përparoj në rrugën e saj drejt kandidaturës në BE me veriun akoma ngurrues, por që përfundimisht po ecte në të njëjtën rrugë me pjesën tjetër të vendit.



Njerëzit duke bërë pazar në veri të Mitrovicës; deri në vitin 2020 ata mund ta shohin Serbinë dhe Kosovën, përfshirë edhe veriun e Kosovës, duke përparuar me vendosmëri drejt anëtarësimit në BE.

Reqësimi i ngadalshëm i situatës derisa fokusi global do të lëvizë çdokund

Veriu i Rqosovës 2020: Distancimi nga integrimet vendore derisa rajoni përjeton zvogëlim të stabilitetit

Dinamika e brendshme Diskriminimi në Serbi ndaj Serbëve të Kosovës të cilët kërkojnë punësim; financimi i Serbëve të Kosovës ndërpritet—pika e fundit që kristalizojnë mosbesimin

Dinamika rajonale Derisa qeveria e Kosovës ëshë nën presion për tu stabilizuar financiarisht, çështja e veriut të Kosovës shkon në prioritetin më të vogël me qëllim të fokusimit në punësim dhe anëtarësim në BE

Politikë Skena politike e Kosovës i sheh partitë e reja duke u ngritur dhe duke rënë; iniciativa civile Srpska po bëhet një forcë politike shumë më e fortë se sa një forcë e parëndësishme që vepron në emër të interesave tjera

Ë sigurisë Krimi i organizuar forcohet në pikëpamje vendore, duke u bërë furnizuesi kryesor i statusit dhe stabilitetit individual; policia e Kosovës dhe forcat e armatosura ngecin për shkak të mungesës së fondeve

Ekonomik Në jug të Kosovës , punësimi i përkohshëm arrin majën për shkak të ndërimit të dy termocentraleve elektrike me thëngjill dhe një investimi të vogël në sektorin e turizmit; ndërsa ekonomia në veri rrëshqet te poshtë

Socio-Kulturor Mungesa e entuziazmit dhe lodhja e Serbëve të veriut të Kosovës pa ndonjë rrugëdalje të emigrimit; barrierat fizike do të largohen por Serbët qëndrojnë fuqimisht në “geton psikologjike”

Rqarakteristikat e skenarit:

- ◆ Derisa ekonomia e Serbisë ka luhaturje e cila kërcënon stabilitetin e saj, ajo do ti përfundon subvencionet e punësimit dhe migrimin e mirëqenë në Rqosovë; Serbët në veriun e Rqosovës shohin këtë si gozhdën e fundit në arkivol për mirëmbajtjen e besimit me Beogradin ose Prishtinën
- ◆ Ndasitë ndërmjet komuniteteve do të forcohen por do të arrihet një marrëveshje modus vivendi, duke krijuar një ndjenjë të Serbëve të Rqosovës ndaj abuzimit permanent të tyre nga njërëziti në pushtet
- ◆ Do të ketë arritje ekonomike afat-shkurtra por edhe pak fërkime në ndryshimet afat-gjate
- ◆ Çështjet buxhetore do të detyrojnë BE-në dhe shtetet tjera të fokusohen çdokund tjetër

3.3 Skenari Tre: Qorrsoakaku dhe pranimi i gjendjes

Ndryshimet në skenën politike të Serbisë ndikuan drejtpërdrejt në përmbajtjen e diskutimeve për fatin e veriut të Kosovës. Presioni i shtuar publik që e detyroi Beogradin të përqendrohet ekskluzivisht në përmirësimin e mundësive për punësim dhe në përshpejtimin e anëtarësimit për në BE me qëllim të qasjes në tregje më të mëdha, ndikoi në zbehjen e tendencave të saj që ta shfrytëzonte Kosovën si “futboll politik”. Si rezultat i kësaj, komuniteti serb në veriun e Kosovës hyri në një fazë të re të udhëtimit të tij problematik.

Ambienti politik në rajonin e Ballkanit u stabilizua ngadalë, derisa Serbia, Maqedonia, Shqipëria dhe Bosnja ia dolën t'i tejkalojnë pengesat dhe të afrohen më pranë BE-së. Transparenca dhe shërbimet publike u përmirësuan pak, por kompromiset ekonomike, të cilat u bënë për t'u harmonizuar me standardet e BE-së, ndikuan më së shumti në xhepin e njerëzve. Qytetarët në Serbi u goditën nga reformat strukturore në punësim dhe shuma e fondeve që ndahej në mënyrë jo adekuate për veriun e Kosovës i indinjoi ata sepse këtë e shihnin si shpenzim të kotë të parasë së 'tyre'. Duke qenë të tensionuar për shkak të tranzicionit drejt praktikave të tregut të lirë të punës, të kërkuara nga BE-ja, shumë serbë në Serbi u ankuan për shkak se vendet e lira të punës u zunë nga serbët 'e pa sofistikuar' nga Kosova, të cilët kishin migruar në Serbi. Për shkak të kritikave publike në Serbi ndaj kësaj dukurie, që qytetarët e perceptonin si padrejtësi, u ndërpre financimi i serbëve të Kosovës dhe i la ata të varur nga punësimi në Kosovë, çka ua zvogëloi edhe mundësinë që të ikin nga Kosova në Serbi. E fundit në vargun e këtyre zhvillimeve të pakëndshme për serbët e Kosovës ishte marrëveshja e Serbisë me BE-në për ta njohur Kosovën, në datën kur ajo të jetë e gatshme për të hyrë në Bashkimin Europian.

Fushata e Serbisë për të përmirësuar gjendjen e saj ekonomike si përgatitje për anëtarësim në BE (fushata është ndihmuar dhe përkrahur nga politikanët që punojnë për ruajtjen e interesave të tyre) bëri që serbët e Kosovës të ndihen të tradhtuar dhe krejtësisht të pafuqishëm për të vepruar. Në pamundësi për të bërë diçka dhe për t'i ndryshuar rrethanat e krijuara, e vetmja zgjidhje që u mbeti të rinjve serbë në veri të Kosovës ishte të nxjerrin më të mirën nga situata e keqe.

Ky pajtim i serbëve çoi në pjesëmarrjen e tyre më të madhe në jetën politike në Kosovë. Duke mos pasur instruksione të fortë nga Serbia, Iniciativa Qytetare Srpska u bë forcë e pavarur politike. Pasi fitoi në shumicën e komunave serbe, Iniciativa Srpska arriti pjekurinë si partia më e madhe politike serbe dhe u shndërrua në forcë të vërtetë politike opozitare serbe në Prishtinë.

Përkundër faktit që serbët u detyruan ta pranojnë gjendjen e tyre, kjo nuk e ndihmoi në masë të madhe integrimin më të mirë në mes veriut dhe jugut. Për shkak të mungesës së përkrahjes nga Serbia, Asociacioni i komunave serbe asnjëherë nuk u materializua. Serbët u ndien si të burgosur në një 'geto' fizike dhe psikologjike, në situatë ku nuk mund t'i besonin as Prishtinës, as gjyqësorit e as çfarëdo premtimi se do të trajtohen në mënyrë të barabartë; si rrjedhojë, të gjitha përpjekjet për t'i implementuar politikat kosovare në veri u sabotuan. Liderët serb në Kuvendin e Kosovës i bllokuan të gjitha përpjekjet për të ndryshuar status quo-në në veri. Këta liderë i përdorin votat e tyre për pazarllëk politik, duke u pajtuar për një legjislacion të ri në këmbim të miratimit të masave që në radhë të parë i dedikohen komunitetit serb.

Banorët e veriut vazhduan të jetojnë pak a shumë në një vend të harruar, gjysmë-autonom dhe me mungesë të ligjit dhe pa përkrahjen publike të shtetit serb. Policia e Kosovës dhe EULEX-i nuk patën mundësi ta ndryshojnë mosbesimin e serbëve ndaj strukturave përgjegjëse për sundimin

Populistiçki nemiri obnavljaju konflikt i novi hladni rat velikih sila

Veriu i Ҙosovës 2020: Distancimi nga integrimet vendore derisa rajoni përjeton zvogëlim të stabilitetit

Dinamika e brendshme

Thatësia dhe pakënaqësia popullore në Prishtinë do të nxitë abuzimin e Serbëve të Kosovës dhe protestat e dhunshme kundër qeverisë; dhuna ndëretnike do të përhapet

Dinamika rajonale

Nacionalistët nxisin trazira përgjatë Ballkanit derisa dhuna ndizet në Bosnjë, Maqedoni dhe Serbi jugore; BE-ja dhe SHBA-ja fajësohen derisa Rusia vepron si llastues

Politikë

Qeveria në Prishtinë do të bie në kolaps me grindjet e fraksioneve partiake gjersa Shqiptarët do të ikin nga veriu në jug dhe Serbët e Kosovës në veri

И sigurisë

Krijimi i forcave rezerviste nga Shqiptarët edhe Serbët, duke krijuar lidhje përtej Ballkanit; policia do të ndahet në mes të MUP-it dhe policisë së Kosovës gjersa Kosova rrëshqet drejt në luftë

Ekonomik

Të gjitha veprimtaritë për anëtarësimin në BE, reformat bankare dhe financiare do të ndërpriten; investitorët largohen nga projektet e infrastrukturës para përfundimit të tyre; do të ketë insolvendë fiskale

Socio-Ҙulturor

Mungesa e shpresës dhe mosbesimi maksimal gjersa komunitetet sulmojnë njëra-tjetrën; dhuna shpërthen përgjatë vijave sektare

Ҙarakteristikat e skenarit:

- ◆ Një pikë e krizës arrihet kur thatësitë e zgjatura ndodhin në jug të Ҙosovës.; Protestat e dhunshme për keqmenaxhim nga Prishtina detyron komunitetin Serb të ikë në veri dhe pjesa e mbetur shqiptare nga veriu të ikë në jug; Be-ja dhe SHBA-ja thirrën për qetësi por ngurrojnë të jenë pjesë e një grindje të re rajonale
- ◆ Duke e shfrytëzuar mundësinë e dhënë, nacionalistët përgjatë Ballkanit kërcënojnë me sulme; Rusia gjithashtu e sheh konfliktin si rast për të kritikuar dështimet e perendimit dhe NATO-s dhe të zgjerojë ndikimin e saj përmes aleancës me Serbinë, armëve dhe "ndihmës së sigurisë" territoriale
- ◆ Ҙlerikët radikal do përdorin kaosin për ti shtyrë agjendat fetare duke ftuar xhihadistët radikal

e ligjit. Shumë të rinj, në pamundësi për t'u punësuar në sektorin publik dhe me pak mundësi për zhvillim ekonomik, bënë karrierë në krimin e organizuar. Edhe pse ishin shënuar disa përparime të vogla në kuadër të lëvizjeve rinore dhe nga përpjekjet e serbëve të moshuar që të arrijnë një modus vivendi me shqiptarët, barrikada në urën e lumit Ibër mbeti simbol i refuzimit të veriut që të heq dorë nga territori. Kosova mbeti e ndarë dhe kjo më nuk kontestohet.

3.4 Skenari Katër: Rëlapsi - Kthimi në gjendjen paraprake

Kushtet klimatike, keq-menaxhimi i burimeve publike dhe gjendja e keqe në sistemin e ujësjellësit në Kosovë kontribuuan në manifestimin e shpejtë të mungesës së ujit, gjatë periudhës që i parapriu vitit 2020. Këto zhvillime jo vetëm që shkatërruan stabilitetin e brishtë të Kosovës, por edhe nxitën trazira të mëdha në rajonin e Ballkanit – që provokoi intervenime dhe krijimin e strategjive gjeopolitike nga ana e Ruisë, BE-së dhe SHBA-ve.

Në Kosovë mbretëronte thatësi e që ishte bërë dukuri e rregullt dhe e përvitshme: të reshurat e shiut dhe borës ishin të pakta dhe ndikonin me mbushjen e pamjaftueshme të baseneve të Batllavës, Badovcit dhe Gazivodës, kurse humbja e ujit u keqësua për shkak të defekteve në rrjetet e ujësjellësit. Deri në vitin 2020, zbrazja e rezervuarit të Badovcit nxiti krijimin e një plani emergjent për kursimin rigoroz të ujit në Prishtinë dhe në komunat rreth saj, që provokoi protesta masive antiqeveritare të shqiptarëve të Kosovës. Mungesa e furnizimit me ujë shënoi kulmin e pakënaqësive të cilat kishin të bëjnë edhe me zhgënjimet për shkak të mungesës së përparimit në reformat ekonomike dhe juridike, në luftën kundër korrupsionit, papunësisë, hipokrizinë e organizatave ndërkombëtare dhe kundër privilegjeve (të perceptuara nga qytetarët) për komunitetin serb.

Pasi protestat disa javore gjatë një vere shumë të nxehtë nuk dhanë rezultatet e pritura, në vend shpërthyen trazirat me ç'rast u sulmuan zyrtarët dhe ndërtesat qeveritare. Kur një politikan deklaroi se serbët janë përgjegjës për thatësitat sepse ata e kishin ndryshuar kahen e rrjedhjes së ujit nga Gazivoda, disa protestues e drejtuan zemërimin e tyre kundër serbëve të Graçanicës. Sulmet kundër serbëve në jug të lumit Ibër ndikuan në shpërthimin e incidenteve ndëretnike në Mitrovicë.

Rrethi vicioz i hakmarrjes e intensifikoi kaosin prandaj u shfaq nevoja për intervenimin e atyre pak patrullave të mbetura të KFOR-it, pas zvogëlimit të forcave të NATO-s në fillim të vitit 2015. Sipas raporteve, pjesëtarët e Forcave të Armatosura të Kosovës në afërsi të Prishtinës qëlluan ndaj qytetarëve serbë. Si rezultat, serbët nga jugu u larguan për në veri sepse kriza e ujit provokoi një gjendje që në shumë aspekte ngjasonte me shpërnguljet etnike të vitit 2004. Serbët u përgjigjën me sulme ndaj shqiptarëve në veriun e Kosovës. Veturat filluan të hidhen në ajër si në jug ashtu edhe në veri të Mitrovicës. Shqiptarët nga veriu e detyruan të ikin në pjesën jugore për shkak të dhunës në rritje në komunat veriore.

Përpjekjet për integrimin e veriut u ndërpre, kurse politikanët shqiptarë dhe serbë të Kosovës shkëmbyen akuza ndaj njëri-tjetrit, duke nxitur kështu shpërthimin e luftës civile. Qeveria e Kosovës u tregua e paafte për të reaguar dhe prandaj ajo u shpërbë. Liderët komunalë në veri të Kosovës u akuzuan se kishin bashkëpunuar me Qeverinë e Kosovës dhe e humbasin legjitimitetin. Grupet e ndryshme etnike në jug dhe veri të lumit Ibër formuan forca të armatosura paramilitare për t'i mbrojtur lagjet e tyre, në të cilat u inkuadruan edhe pjesëtarë të Policisë së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Kosovës.

Serbia, e ballafaquar me zemërimin e popullit dhe me një valë të re refugjatësh, e rriti temperaturën e konfrontimit: mjetet e informimit të kontrolluara nga shteti i akuzuan shqiptarët për 'gjenocid', në ndërkohë që Beogradi filloi t'i përkrahë serbët e Kosovës me armë dhe këshilla taktike. Përshkallëzimi i gjendjes në Kosovë ndikoi në përhapjen e përplasjeve ndëretnike në Bosnjë, Maqedoni dhe Serbinë Jugore.

Përderisa grupet e ndryshme u rreshtuan përgjatë kufijve në rajon, Këshilli Sigurimit të Kombeve të Bashkuara u mbledh për t'i diskutuar opsionet për ndërprerjen e dhunës. Seancat e Këshillit të Sigurimit u përcollën me debate të nxehta: Rusia akuzoi BE-në dhe SHBA-të për nxitjen e dhunës duke përkrahur pavarësinë e Kosovës, pa ofruar garanci të mjaftueshme për komunitetin serb në Kosovë. Meqenëse gjasat për miratimin e një rezolute nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ishin të vogla, shtetet anëtare të NATO-s u mbledhën për t'i diskutuar strategjitë për shuarjen e konfliktit. Duke e parë mundësinë që edhe më shumë ta dobësojë pozitën e NATO-s në Evropë, Rusia hyn në 'lojë'. Përveç paralajmërimeve drejtuar Perëndimit, Rusia e bindi Serbinë, në takime të fshehta, që ta forcojë aleancën e saj me Organizatën e Traktatit të Sigurisë Kolektive përtej statusit të vëzhguesit, në këmbim të armëve dhe trupave ushtarake. Serbia filloi të dërgojë armë në Kosovë dhe Bosnjë, përderisa personeli ushtarak rus pa uniforma hyri në veri të Kosovës dhe ndihmoi në mbajtjen e këtij territori nën kontrollin serb. Me Rusinë në lojë, NATO, BE-ja dhe SHBA-të nuk ishin të gatshme të rrezikojnë një konflikt të ri rajonal. Kosova rrëshqiti në luftë, ku lumi Ibër u bë vija kryesore e frontit.

Kjo dekadë përfundoi me ndarjen definitive të veriut nga pjesa tjetër e Kosovës dhe ndarjen në mes të serbëve dhe shqiptarëve, duke mos u lënë komuniteteve të tjera asnjë mundësi tjetër përveç mbijetesës fizike. ♦



© Helmi Mas

Ura kryesore mbi lumin Ibër; deri në vitin 2020, lumi Ibër mund të bëhet vija e frontit i një konflikti të përtëritur ndërmjet Serbëve dhe Shqiptarëve.

4. Shtytësit

Shtytësit janë motorët e ndryshimit që do të gjenerojnë ngjarje dhe do të ndikojnë në to, deri në vitin 2020. Shtytësit paraqesin rezultatet e bazuara në marrëdhëniet e ndryshueshme në mes aktorëve, strukturave dhe kushteve në secilën situatë. Si rrjedhojë, bashkëveprimi i këtyre variablave përcakton zhvillimin e skenarëve në veri të Kosovës dhe më gjerë. Shtytësit evoluojnë me kohë dhe janë manifestime tipike të forcave të brendshme dhe, në një shkallë më të vogël, edhe të forcave të jashtme të cilët formësojnë sjelljen e njerëzve dhe institucioneve. Ky raport identifikon katër shtytës kryesorë të ndryshimeve: shtytësit politik, të sigurisë, ekonomik dhe socio-kulturor.

4.1 Shtytësit politik

SUNDIMI I DOBËT I LIGJIT, ZBATIMI DHE RESPEKTIMI

Shumë nga problemet e mprehta që lidhen me sundimin e ligjit burojnë nga sistemi në Kosovës: në nivel qeverisës pushtetin e karakterizon sundimi i dobët i ligjit që mundëson korrupsionin, i cili e rrit ndikimin jo vetëm të politikanëve, por edhe të gjyqtarëve të korruptuar. Kjo përcillet poshtë deri në nivelet më të ulëta të shoqërisë, ku qytetarët e zakonshëm kanë frikë sistemi i cili nuk është në gjendje ta promovojë drejtësinë. Disa nga shqetësimet më të mëdha në këtë fushë janë: ndërhyrjet e politikës në punën e gjyqësisë, mbrojtja e personave të përfshirë në proceset gjyqësore, lëndët e papërfunduara dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore.²

Problemet në sistemin gjyqësor i kufizojnë mundësitë që Kosova t'i tejkalojë sfidat e tjera. Sistemi gjyqësor joadekuat është një disavantazh për të gjithë, përveç më të fuqishmëve, dhe i vë komunitetet pakicë, të cilat nuk kanë lidhje brenda sistemit për t'i mbrojtur interesat e tyre, në pozitë edhe më të pafavorshme.

Shtytësit kryesor sipas rëndësisë:



Motorët primarë të ndryshimeve që do të ndikojnë në veriun e Rësovës deri në vitin 2020

Qështjet mjaft të rëndësishme që do të ushqejnë shtytësit

Menaxhimi i dobët i ujësjellësit dhe pamjaftueshmëria që çon në thatësi

Furnizimi i dobët me energji dhe me burimet e ndotura (ligniti)

Kufizimi i mjeteve objektive të informimit

Rrezikimi i sistemit arsimor me sfida të akreditimit

Lufta rreth liberalizimit të vizave

Ndotshmëria e pas luftës dhe opsionet e dobëta të kujdesit shëndetësor

Diskutimet aktuale në dialogun Kosovë-Serbi për zyrtarizmin e ndarjes etnike në sistemin gjyqësor - që është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës - mund ta mbajnë gjallë rrethin vicioz të përfaqësuesve qeveritarë të korruptuar dhe elektoratit të tyre mosbesues. Kjo situatë kontradiktore e rrënon mundësinë e stabilizimit të gjendjes së pakicave përmes sundimit të ligjit, të cilët janë të hutuar dhe zemëruar për shkak të moszgjidhjes së çështjeve si përdorimi i gjuhës, trajtimi i barabartë dhe mënyra se si po vepron në rastet që kanë të bëjnë me kthimin e pronës. Në këtë mandat de fakto të ndarë, zbatimi i vendimeve gjyqësore mund të zvarritet duke i lënë disa raste në harresë. Vëzhguesit e këtij kaosi ligjor nuk janë të gatshëm të përkrahin ose të pajtohen me përpjekjet e mëtutjeshme të Qeverisë së Kosovës ose BE-së për të imponuar strukturat që qytetarët i konsiderojnë edhe më të dëmshme.

Gjatë periudhës së tranzicionit nga sistemi serb në atë kosovar, banorët e katër komunave në veri të Kosovës kanë mbetur pa gjykata funksionale.³ Transformimi i institucioneve serbe në subjekte kosovare dhe përcaktimi i rregullave të funksionimit të Asociacionit të komunave serbe do të jenë ngjarje të shënuara, shumë të rëndësishme për të qartësuar sistemin juridik të Kosovës. Sidoqoftë, në kohën e përgatitjes së këtij shkrimi këto ngjarje historike nuk kanë ndodhur. Edhe po të kishim qartësi juridike, kundërshtimi dhe apatia që kanë shprehur një pjesë e serbëve ndaj sistemit juridik të Kosovës do t'i dëmtonte përpjekjet për ta përmirësuar këtë sistem. Kjo rezistencë nxitet nga përvojat e serbëve që jetojnë në jug të Kosovës, të cilët përkundër përfshirjes në sistemin kosovar, ankohen në diskriminime të natyrës administrative dhe mbrojtjen e pamjaftueshme të të drejtave të tyre nga sistemi gjyqësor. Disa serbë janë të mendimit se i kanë bërë vetes një shërbim të keq që nuk janë ankuar apo nuk kanë protestuar më shumë para se të integrohen. Ata tërheqin vërejtjen për hendekun e madh në mes të ligjeve të mira dhe praktikave të këqija të zbatimit të tyre në jetën e përditshme.⁴ Shqetësimet e qytetarëve se janë pjesë e sistemit të prishur të Kosovës kanë arritur në atë pikë sa që disa të intervistuar, pjesë e një fokusit grupi në veri të Kosovës, kanë bërë thirrje ose për krijimin e një komisioni të përhershëm për të drejtat e njeriut ose për mbrojtje nga Gjykata e Strasburgut për të Drejtat e Njeriut.⁵

Një çështje e rëndësishme e sundimit të ligjit që ndikon në veriun e Kosovës është trashëgimia e luftës ku bëjnë pjesë⁶: krimet e luftës, personat e zhdukur, personat e zhvendosur dhe çështjet pronësore që vazhdojnë të ndikojnë në marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë. Si serbët ashtu dhe shqiptarët ndjejnë se është bërë fare pak për t'i adresuar masakrat, sidomos ato të kryera nga pala tjetër, dhe secila palë denoncon përgjegjësit të cilët ende mbajnë pozita të larta dhe të rehatshme.

Hallkat e dobëta në sistemin gjyqësor shtrihen edhe në zbatimin e ligjit. Pas vitit 1999, veriu i Kosovës nuk është demilitarizuar: policia, e gjetur në mes të dy sistemeve juridike, thjesht nuk ka mundur të zbatojë ligjin. Mosndëshkimi ishte pothuajse absolut, duke përfshirë edhe qarkullimin e veturave pa targa të regjistrimit, tezgat ilegale në rrugë, kontrabandën e nivelit të vogël dhe të madh dhe frikësimet e dhunshme kundër bizneseve, rivalëve politik, individëve dhe organizatave që punojnë me shqiptarët. Përderisa nivelet e përgjithshme të krimit në veri të Kosovës nuk janë dukshëm më të larta se sa ato në jug, shtrirja e praktikës së mosndëshkimit ka forcuar një kulturë tashmë të rrënjosur në gjithë Kosovën, ku rreziqet nga raportimi i një krimi janë shumë më të mëdha se çfarëdo përmbushje e drejtësisë. Hetuesit kanë vështirësi të mëdha të marrin informacionet e nevojshme për veprat kriminale, që ka për pasojë mungesë në kredibilitet. Reformimi i sistemit gjyqësor do të dështojë nëse atij nuk i besohet. Integrimi i pjesëtarëve të Ministrisë së Brendshme të Serbisë në Policinë e Kosovës mund ta përmirësojë



Veturat pa numrat e targave janë një shenjë e dukshme e sfidave me të cilat ballafaqohet sundimi i ligjit në veri të Kosovës.

respektimin e ligjit dhe mund të jetë një pikë kthese për sundimin e ligjit në veri, por për një gjë të tillë nevojitet përkrahja publike nga Serbia dhe nga kryetarët e komunave me shumicë serbe.⁷

Forcimi i sundimit të ligjit në veri të Kosovës megjithatë do të kërkojë shumë më tepër se sa vetëm tejkalimin e kundërshtimeve të qytetarëve ndaj çfarëdo mekanizmi të ri ligjor që do të provohet të instalohet atje. Çdo rindërtim i suksesshëm i sundimit të ligjit do të kërkojë një projeksion të serishëm dhe të rëndësishëm shoqëror dhe strukturor në fushën e besimit publik në mënyrë që të ketë zbatim dhe respektim të ligjit.

VËSHTIRËSITË ELEKTORALE

Edhe pas Marrëveshjes së Brukselit, kandidatura për funksionin politik në veri të Kosovës është, sipas shumë zyrtarëve vendorë e ndërkombëtarë, një punë e rrezikshme. Vrasjet, frikësimet dhe arrestimet i kanë dëmtuar kandidatët në gjithë spektrin politik. Votuesit Serb në veri dhe jug të Kosovës ballafaqohen me frikësim për të votuar, ose mos të votojnë, ose të votojnë për një parti të caktuar politike. Kandidatët Serb nga veriu i Kosovës në zgjedhjet komunale të fundit i kanë konsideruar zgjedhjet të jenë me status neutral, kurse zyrtarët Kosovar i kanë konsideruar ato të jenë pjesë e sistemit të Kosovës. Politikanët nga Serbia kanë imponuar besnikëri partiake dhe frikë tek Serbët e Kosovës me qëllim të përkrahin partitë e caktuara, nganjëherë edhe kanë përhapur dezinformata rreth qëllimeve të Serbisë për të dhënë subvencione Serbëve të Kosovës—një shkelje e përgjegjësisë së Serbisë të përcaktuar në Marrëveshjen e Brukselit dhe një mashtrim ndaj kushteve të caktuara për Asociacionin e Komunave Serbe.

Vështirësitë e qarta në apelimet ndaj një popullate pakicë e të shqetësuar – të ndarë nga lojaliteti ndaj Serbisë, ndjenja e tyre e tradhtisë pasi ata shohin se Serbia i ka shitur ata me nënshkrimin

Asociacioni i Rromunave Serbe

Përveç se paraqet një arritje të rëndësishme në marrëdhëniet R Kosovë-Serbi dhe për gjendjen në veriun e Kosovës, dykuptimësia e Marrëveshjes së Brukselit dhe implementimit të saj paraqet një barrierë drejt normalizimit të raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Duke lejuar mos-përpikëri të mjaftueshme në gjuhën dhe në kriteret lehtësuese të marrëveshjes ndërmjet të dy palëve, negociatat kanë sjellë një situatë të mundshme problematike për njërën nga shtyllat kryesore të saj: krijimin e Asociacionit të Rromunave Serbe. E dizajnuar për të lehtësuar përfshirjen e katër komunave Serbe në veri të Kosovës në një kornizë të unifikuar kombëtar, Asociacioni i Rromunave Serbe përfshinë arsimimin, kujdesin shëndetësor, iniciativat ekonomike dhe planifikimin urban dhe rural – në këto fusha ku komunat veç kanë autonomi sipas Kushtetutës së Kosovës.

Vështirësitë paraqiten gati menjëherë, duke filluar me emrin e saj. Zyrtarët kosovar e lexojnë këtë si një 'shoqatë' dhe, si rrjedhojë, e interpretojnë si një aleancë e përkohshme e painkorporuar—më shumë një entitet kalimtar i ndërtuar për shkëmbim të informatave. Për Serbët, ky bashkim është një 'komunitet' ose 'union', e cila i jep këtij grupi de fakto statusin ligjor dhe mandatin për të qeverisur. Shqiptarët e Kosovës kanë frikë se Asociacioni i Rromunave Serbe do të kenë fuqi ekzekutive. Në dallim prej kësaj, Serbët e Kosovës kanë frikë se Asociacioni i Rromunave Serbe nuk do të kenë fuqi ekzekutive.

Për të qenë edhe më e komplikuar është konflikti në mes të Kushtetutës së Kosovës dhe ligjeve dhe implikimit ligjor të Asociacionit të komunave serbe—një strukturë e cila kërkon dy të tretën e shumicës së votave në Ruvendin e Kosovës për të rishikuar ligjet ekzistuese në mënyrë që të implementohet. Ndryshimet në ligjet ekzistuese duhet gjithashtu të kërkojnë edhe nga Serbia.⁸ Spektri i plotë i revizioneve ligjore në mënyrë që të kodifikohet çdo lidhje për themelimin e Asociacionit të Rromunave Serbe është, në momentin e këtij shkrimi, ende i papërfunduar, sikurse edhe elementet tjera të rëndësishme për Asociacionin e Rromunave Serbe, siç është afati kohor dhe etapat për themelimin e saj. Ndoshta më e rëndësishmja është mungesa e qartësisë së raporteve të Asociacionit të Rromunave Serbe me Beogradin dhe Prishtinën. Në nivelet e menjëhershme, ky problem shfaq në vetvete emërimin e ekipit menaxhues për Asociacionin e komunave serbe. Kurse anëtarët e ekipeve menaxhuese duhet të propozohen formalisht nga komunat e veriut dhe të mbështeten nga një autoritet i Kosovës, në realitet Beogradi e emëron dhe e udhëzon këtë ekip. Për pjesën e saj, ekipi menaxhues ka nënvizuar disa herë që punon ngushtë me komunat dhe është emëruar në përputhje me specifikat e dhëna në Marrëveshjen e Brukselit. Ky konfuzion, i cili mund të shpërfaqet në një datë të vonshme si një konflikt, manifeston saktësisht të kundërtën arritje për të cilën është përpiluar Marrëveshja e Brukselit. Precedentët si kjo krijojnë pika veprimi për mosmarrëveshjet në të ardhmen për atë se cili shtet ka juridiksionin e fundit ligjor mbi Asociacionin e komunave serbe.

Do të kërkohet shumë ndërmjetësim për të arritur deri te qartësia dhe saktësia të cilat mungojnë në marrëveshjen e tanishme. Pa besim të mirë në të gjitha anët për të arritur qëllimet që të dyja palët kanë nevojë për—si p.sh., marrëdhënie funksionale, si dhe saktësia dhe marrëveshja për juridiksionin territorial, në mënyrë që Prishtina dhe Beogradi mund ta përmirësojnë kualitetin e jetës së qytetarëve të tyre—koha dhe energjia tani e harxhuar mbi kompromiset në negociata, si marrëveshja për themelimin e Asociacionit të Rromunave Serbe, mund të shkoj në asgjë. Në ndërkohë, gjersa e gjithë kjo energji harxhohet, Kosova mund të gjenerojë më shumë vullnet të mirë nga komunitatet Serbe në veri duke thjeshtë i dhënë përparësi ofrimit të shërbimeve elementare publike si menaxhimi i ujit dhe mbeturinave.

e Marrëveshjes së Brukselit, dhe nevojës për tu marrë me një të ardhme që ata nuk e duan—i bëjnë angazhimet politike në veri të Kosovës shumë të vështira. Pengesat më të mëdha gjenden në kompleksitetin e një universi më të madh politik të Kosovës. Për më tepër, sfera politike e Kosovës është dobësuar nga mungesa e kundërpeshave të efektshme ndaj taktikave të Serbisë për të pasur ndikim në punët e Kosovës.

Në fillim të vitit 2014, Kosova nuk ka hiq më shumë se 8 parti politike kryesore me ulëse në Kuvend; gjithashtu ka të regjistruar 6 parti të vogla dhe 15 parti të komuniteteve pakicë. Koalicionet qeverisëse janë të nevojshme duke pasur parasysh se mungon mazhoranca e arritur nga një parti e vetme, por kjo komplikohet nga mjediset historike të shumë partive dhe liderëve të tyre. Aleancat gjatë luftës, marrëdhëniet familjare dhe punët me biznes paraqesin koloritin në çdo strukturë partiake dhe e cila mundet ta stimuloj ose të anuloj ndërtimin e një koalicioni, duke e vështirësuar krijimin e një qeverisje që mund të plotëson interesat dhe kërkesat e publikut në tërësi.

Në teori, diversiteti partiak sugjeron një demokraci të shëndetshme; por në realitet, Kosova punon me një deficit të dallueshëm demokratik. Zgjedhjet janë njollosur nga mashtrimet, vjedhjet dhe turbullirat. Negociatat në dhoma të mbyllura janë rregull se sa përjashtim, dhe mungesa e transparencës shkatërron legjitimitetin. Fragmentimi politik është bërë normë.

Këto vështirësi janë rritur shumë kur Serbia e fut dorën e saj në këtë ngatërresë. Dhjetë parti Serbe janë të regjistruar në Kosovë dhe një në veçanti, Iniciativa Qytetare Serbe (Građanska Inicijativa Srbija, e referuar ndryshe si Srpska), e cila ka qenë në krye të zgjedhjeve në komunat me shumicë Serbe. Përderisa politikanët në Beograd inkurajojnë Serbët në veriun e trazuar të Kosovës të marrin pjesë në procesin zgjedhor në Kosovë, si plotësim i obligimit të tyre për të normalizuar raportet me Kosovën, ata, në mënyrë të qartë, e shfrytëzojnë Srpskan si mjetin e tyre politik. Kjo ka nxitë një shqetësim të ri tek Shqiptarët e Kosovës. Më herët, ata kishin frikë se një marrëveshje me Serbinë do të krijojë një shtet të paqëndrueshëm, në të cilën Serbët nga veriu i Kosovës do ti bllokoni proceset e vendim-marrjes. Tani ata kanë frikë se Beogradi ka mundësi të përzihet drejtpërsëdrejti në punët e brendshme të Kosovës përmes Srpskas. Mungesa e aftësive në negociatat strategjike dhe në taktikat e informimit e vendos operativin politik të Kosovës në një disavantazh të dallueshëm për të iu përgjigjur veprimeve të Serbisë, duke interpretuar tërë procesin elektoral të cënueshëm ndaj kooptimit.



Grafitet me shqiponjën Serbe tregojnë për rezistencën Serbe në veri të Mitrovicës – "Mitrovica e Kosovës: Nuk ka rrugëdalje nga ky vend".

REZISTENCA NDAJ IMPLEMENTIMIT TË MARRËVESHJES SË BE-SË

Rezistenca publike e Serbëve të Kosovës kundër implementimit të Marrëveshjes së Brukselit është përhapur, por ndryshon nën hije: Në spektrin e parë, ekziston një pjesë e shoqërisë në rritje e sipër e cila përbëhet nga pjesëtarët që nuk e dëshirojnë Marrëveshjen e Brukselit dhe mbesin të përmbajtur nga integrimi ndër-etnik (pa e mohuar atë haptazi), por edhe të cilët heqin dorë dhe pranojnë fatin e tyre në kuadër të mungesës së alternativave më të mira ekonomike. Në spektrin e mesëm janë ata pjesëtarë të cilët e kundërshtojnë fuqishëm implementimin, por shprehin pakënaqësi nëpërmjet metodave jo të dhunshme, si bojkoti, barrikatadat dhe refuzimin e simboleve shtetërore të Kosovës. Në spektrin e fundit ekziston opozita e dhunshme, e përbërë nga pjesëtarët e krimit të organizuar të cilët kërkojnë ti parandalojnë humbjet financiare, të cilët mbështesin ideologjitë hakmarrëse nacionaliste, dhe huliganët dhe tifozët e futbollit që kërkojnë një luftë, të cilat ndonjëherë paguhen nga ata kanë interesat e tyre personale.

Rezistenca e qytetarëve nxitet nga 'investimet' fiskale që Serbia i bën në Kosovë. Pensionet, stipenditë shtetërore, pagat dhe subvencionet janë paguar nga Serbia për qytetarët Serb që jetojnë dhe punojnë në Kosovë, edhe nëse ata tani marrin një pagë nga Kosova—një situatë ku Kosova dhe Serbia janë munduar të merren me këtë çështje, gjatë dialogut ndërmjet tyre. Detajet ende janë të paqarta, por ndërprerja e mundshme e ndihmave të Serbisë do të jetë një burim i frikës dhe tensioneve në mes të Serbëve të cilët jetojnë në një Kosovë të sfiduar ekonomikisht. Për këtë transfer të drejtpërdrejtë të ndihmave, e cila përbën përafërsisht 500 milion Euro në total, mund të heq dorë Serbia dhe ta kanalizojë përmes Asociacionit të komunave serbe. Megjithatë, në kohën kur bëhet ky raport, struktura e Asociacionit të komunave serbe është ende në pikëpyetje. Shërbimet publike të siguruar nga Serbia, si telekomunikacioni, mjetet e informimit dhe energjia, kanë qenë burim i kontestit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ndërsa

institucionet gjyqësore dhe ato të shërbimit civil të menaxhuara nga Serbët duhet të mbyllen dhe të transformohen në favor të Kosovës, e cila kërkon infrastrukturë ligjore dhe administrative që ende nuk janë plotësisht të zbatueshme. Si rrjedhojë, rezistenca popullore ndaj implementimit është më shumë një reagim pragmatik sesa emocional.

Në nivelin politik, rezistenca ndaj Marrëveshjes së Brukselit shihet jo vetëm në qëndrimin e dykuptimtë të aktorëve në Serbi, të cilët në të njëjtën kohë deklarojnë pëlqimin e tyre ndaj Marrëveshjes dhe refuzojnë njohjen formale të Kosovës, gjersa punojnë për ti mbajtur Serbët e Kosovës në anën e tyre, por edhe ndërmjet veti në Kosovë. Shembujt e rezistencës direkte janë refuzimet e kandidatëve në zgjedhje për të dhënë betimin ndaj shtetit të Kosovës. Ndoshta më e dëmshme do të ishin shembujt indirekt, sikur liderët politik Shqiptarë të Kosovës të cilët dështojnë të ofrojnë një mundësi tërheqëse për ti afruar komunitetet së bashku dhe mungesa e përgatitjeve që i ka parandaluar zyrtarët të marrin masa të shpejta për krijimin e shërbimeve të qëndrueshme dhe të kornizave qeverisëse që garantojnë largimin e tyre nga strukturat e menaxhuara nga Serbët. Rezultati i fundit do të jetë zgjidhja e ngadalshme e qëllimeve të Marrëveshjes së Brukselit për ti bashkuar kampet opozitare.

4.2 Shtytësit e sigurisë

KRIMI I ORGANIZUAR E I QËNDRUESHËM TRANSNACIONAL

Gjersa tensionet ndëretnike paraqesin rrezikun më të madh afat-mesëm ndaj integritetit të Kosovës, kërcënimi i sigurisë afat-mesme dhe afat-gjate varet nga shkalla e vendosjes së krimit të organizuar transnacional në rrënjët brenda sistemit politik. Madhësia e problemit përbëhet jo vetëm nga rreziku i stabilitetit vendor të Kosovës por edhe i stabilitetit rajonal në Ballkan dhe më gjerë në Evropë.

Krimi i organizuar dhe korrupsioni mbesin sfidat kryesore të sundimit të ligjit në Kosovë në fushat e saj politike, të sigurisë, ekonomike dhe sociale. Nga zyrtarët e intervistuar, kemi kuptuar se ekziston një konsensus që problemi është më së shumti i përqendruar në lidhjet ndërmjet politikanëve dhe krimit të organizuar. Raportet ditore nga gazetatat dokumentojnë hetimet, arrestimet dhe paditë të punëtorëve të qeverisë të cilët merren me shantazhe dhe ndikime të fuqishme. Marrja e ryshfetit është pjesë e status quo-së dhe lidhjet e saj me sindikatat e krimit të organizuar janë të zakonshme. Edhe pse raportet e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krime tregojnë një ulje të vogël në trafikimin e drogës, nga intervistat me Policinë e Kosovës paraqiten vërejtjet se ky problem duket se prapë do të rritet, veçanërisht në lidhje me lëndët narkotike, për shkak të prezencës së bandave Shqiptare dhe pozitës strategjike që ka Kosova. Sipas vlerësimeve, rrjeti Shqiptar i krimit të organizuar kontrollon një pjesë të madhe të tregtisë së heroinës dhe Kosova shërben si një stacion kryesor i shpërndarjes ndërmjet tregjeve të Turqisë, Afganistanit, Pakistanit dhe BE-së.⁹ Për shkak të diasporës globale, grupet mafioze Shqiptare janë përhapur, me struktura të avancuara logjistike dhe kanë krijuar lidhje me kartelat e lëndëve narkotike në Amerikë dhe Azi.¹⁰ Por Shqiptarët nuk janë vetëm: pozita strategjike e veriut të Kosovës si rrugë tranzitore për mallra ilegale, i ka lejuar Serbët dhe Shqiptarët ti tejkalojnë ndasitë e tyre etnike për të bashkëpunuar dhe përfituar nga jo-stabiliteti politik dhe mungesa e ligjit—një formë e bashkëpunimit ndër-etnik të cilat mbeten të fuqishëm edhe ditëve të sotit.

Zyrtarët e kategorizojnë kërcënimin nga krimi i organizuar në tri nivele. Në nivelin e poshtëm janë më pak të fuqishëm: hajnat të cilët merren me vjedhje të vogla dhe shërbejnë si muskujt

për lojtarët më të mëdhenj. Në nivelin e mesëm janë bandat lokale të cilët ndihmojnë dhe mbështesin rrjetet e kontrabandimit duke i mundësuar ekonomisë së zezë të vazhdojë të jetë aktive, qoftë me duhan, lëndë djegëse, ose vetura të vjedhura. Në maje të zinxhirit të krimit janë bandat shumë të fuqishme aktivitetet e të cilëve, përveç aktivitetëve tjera, zgjerohen në shpërndarjet e drogës, trafikimin e njerëzve dhe armëve.

Zyrtarë të BE-së dhe SHBA-së besojnë se ata duhet të ndërmarrin 'masat e nevojshme' të angazhimit të politikanëve me histori të dyshuara, sepse ata thjeshtë nuk kanë alternativa të tjera. Megjithatë, gjersa rrjetet transnacionale të krimit e rrisin fuqinë relative kundrejt qeverive dhe kapaciteteve të tyre për udhëheqje dhe kontroll, Kosova parashikohet të jetë një shtet i dobët nëse nuk mund të menaxhojë arritjet e nevojshme në kompetencat administrative, integrimin ndër-etnik, sundimin dhe zbatimin e ligjit.

ZHVILLIMI I FORCËS USHTARAKE MBROJTËSE/KOMBËTARE

Që nga lufta e vitit 1999, Kosova ka qenë më së shumti e mbështetur nga forca e Kosovës e udhëhequr nga NATO (KFOR) për sigurimin dhe mbrojtjen e saj. Themelimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në vitin 2009 është bërë për të plotësuar misionin e KFOR-it duke përbushur nevojat emergjente: kërkimi dhe shpëtimi; largimi i eksplozivit dhe i materialeve të dëmshme; dhe mbrojtjen nga zjarri. Por tani që KFOR-i është i obliguar të caktoj numrin e trupave pasi misioni i saj po zvogëlohet, transformimi i FSK-së në një forcë të plotë të armatosur përbën edhe një shtyllë e cila i distancon më tej Serbët nga Shqiptarët. Në Mars të vitit 2014, Kosova ka deklaruar se do të fillon zhvillimin e Forcave të Armatosura të Kosovës (FAK), duke filluar me 5,000 trupa aktive dhe 3,000 trupa rezervë, me pritjet që FAK-u do të jetë plotësisht aktiv deri në vitin 2024.¹¹

Për Shqiptarët një ushtri e fortë përfaqëson forcimin e shtet-ndërtimit: një shenjë e fuqisë dhe legjitimitetit, si dhe një simbol i identitetit të sovranitetit. Për Serbët e Kosovës themelimi i një ushtrie të Kosovës është burimi i frikës: një emblemë e armatosur nën kontrollin Shqiptarë mbi jetët e Serbëve e cila mund të drejtohet kundër tyre në të ardhmen.

Edhe Shqiptarët dhe Serbët kanë rezerva të mëdha për largimin e trupave të KFOR-it: ata shihen si një burim i sigurisë dhe stabilitetit, edhe pse prezenca e tyre nuk durohet nga Serbët (në veçanti në veriun e Kosovës) sepse kjo shihet si dëshmi e humbjes së tyre dhe nënshtrimit para Shqiptarëve. Ekzistenca e pasigurt, premtimet të perealizueshme për krijimin e një force, ngrisin pyetjet për kapacitetin e lidershipit dhe si trajtimi i barazisë do të zgjatet, qoftë brenda forcave ose në duart e tyre.

NATO-ja dhe Kombet e Bashkuara kanë reaguar me kujdes të shtuar ndaj lajmërimit për themelimin e ushtrisë, duke i rikujtuar Kosovës që Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nr. 1244 ende mbetet në fuqi dhe NATO-ja preferon që Kosova të pres derisa ti rivlerësoj nivelet e angazhimit të saj. Megjithatë, Ambasada e Shteteve të Bashkuara ka qenë e para që ka mirëpritur zhvillimin e sektorit të sigurisë së Kosovës.

Përtej këtyre brengave ekzistojnë vëmendjet më praktike: do të merr aq kohë dhe burime financiare për të ndërtuar një forcë ushtarake në Kosovë, e cila duhet të bëhet në bashkëveprim me iniciativat e tjera të komplikuar të shtet-ndërtimit. Duke e shikuar mënyrën se si karakterizohet politika në Kosovë, ende ka optimizëm në vlerësimet për realizimin e një force ushtarake funksionale që përfaqëson të gjithë qytetarët.



Integrimi i pjesëtarëve të Policisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë në Policinë e Kosovës mund të përmirësojë zbatimin e sundimit të ligjit në veri të Kosovës.

KAPACITETI VENDOR I PAMJAFTUESHËM PËR SIGURI

Një nga sukseset më të prekshme të Marrëveshjes së Brukselit gjer tani është transformimi i Policisë së Kosovës. Derisa është parë një përparim i kufizuar në lidhje me doganat dhe në marrëveshjet për akcizat për komunat Serbe në veri të Kosovës dhe përparimi në sistemin gjyqësor dhe në integritet ka ngecur që nga fillimi i vitit 2014, vetëm zhvillim i ngadalshëm por i qëndrueshëm i Policisë së Kosovës ka qenë një shenjë e vogël e shpresës.

Një sfidë kryesore me të cilën ballafaqohet Policia e Kosovës ishte integriteti i 280 pjesëtarëve të ish Policisë së Ministrisë së Brendshme të Serbisë në Polici të Kosovës. Policia e Ministrisë së Brendshme të Serbisë ka qenë i vetmi grup që ka pasur respekt dhe legjitimitet te Serbët e Kosovës për siguri. Edhe pse ata fillimisht janë cilësuar si të shitur nga Serbët vendorë për shkak se kanë punuar me Policinë e Kosovës, toleranca e vazhdueshme e pjesëtarëve të policisë së Ministrisë së Brendshme të Serbisë dhe rritja e përgjithshme e pjesëtarëve të policisë si pasojë e integritetit ka qenë një faktor në uljen e 5% të krimeve të vogla dhe incidenteve ndër-etnike në veriun e Kosovës që nga fillimi i vitit 2014.¹² Gjithashtu, forcat e përziera të Policisë së Kosovës kanë dhënë një shembull të fuqishëm për bashkëpunimin ndërmjet Serbëve dhe Shqiptarëve. Vëzhguesit kanë vërejtur se si këto ndryshime, deri në një shkallë të kufizuar, kanë përforcuar rritjen e mirëpritjes. Sidoqoftë, problemet kurrë nuk janë më larg: në Mars të vitit 2014, pjesëtarët e Policisë së Kosovës kanë sulmuar dhe arrestuar një rrjet të pretenduar të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës dhe një pjesëtar të Policisë së Ministrisë së Brendshme të Serbisë për posedim të armëve, eksplozivave dhe USB disqeve që përmbajnë informata të ndjeshme për pjesëtarët e Policisë së Kosovës.

Përveç disa hapave të vogla përparuese, kapaciteti i sigurisë vendore në veri të Kosovës është ende i pamjaftueshëm. Prezenca e lëndëve narkotike në veri të Kosovës është duke u rritur

dhe Policia e Kosovës është e brengosur që mundet me qenë e tejkaluar nga forcat e fuqishme dhe të financuara mirë dhe ata brengosen që nuk kanë pajisje të mjaftueshme për ti sfiduar ata. Dhuna e të rinjve gjithashtu po rritet: papunësia dhe energjia e papërqendruar po rezultojnë me huliganizmin tipik të futbollit dhe me lëvizje të djathta sikur që është *Obraz* dhe *Nasi 1389* për të formuar një kombinim të dhunshëm. Pa sistemin funksional gjyqësor dhe mungesa e standardeve dhe juridiksioneve të qarta administrative, çfarëdo avancimi që Policia e Kosovës tani është duke pretenduar mund të avullojë para se BE-ja, Prishtina dhe Beogradi mund të merren vesh dhe të vendosin kornizat.

4.3 Shtytësit Ekonomik

KORRUPSIONI ENDEMIK

Korrupsioni është fajtori që e pengon lëvizjen e ekonomisë së Kosovës. Çdo lloj transaksioni, nga shkëmbimet më të thjeshta vendore e deri te marrëveshjet multi-milionë dollarësh, mund të përfshihet nga nepotizmi, ryshfeti, ndikimet e ndryshme ose shantazhi. Në veri të Kosovës, banorët bëjnë shaka me rutinën e zakonshme ‘3, 5, 7’—metodë përmes së cilës njerëzit e risin ryshfetin për të kryer një punë; së pari ofrojnë 3000 njësi të monedhës (qoftë në euro ose dinar serb) dhe nëse kjo dështon ofrohen 5,000, duke u mbyllur përfundimisht me 7,000, një pikë ku zakonisht arrihen marrëveshjet reciproke.

Në nivel publik, korrupsioni është aq i rrënjosur sa që kufijtë që ndajnë sjelljet etike nga ato joetike kanë humbur kuptimin për qytetarin e zakonshme. Mjekët i caktojnë takimet me pacientët në atë mënyrë që njerëzit iu ofrojnë atyre para fshehurazi (shuma më të larta se tarifat e shërbimit) duke besuar se trajtimi i mirë kërkon ryshfet. Te komuniteti serb i Kosovës, praktikatat e korrupsionit që shpesh përfshijnë bashkëbisedues apo sponsorë financiar nga Serbia, shihen si mekanizma të mbijetesës në një ambient ku ata ndihen të kërcënuar. Nga ana tjetër, në kulturën shqiptare theksi vihet në besnikërinë ndaj familjes, që nënkupton se lidhjet personale mbizotërojnë ndaj zgjedhjeve objektive, si në punësim ashtu edhe në tregti.

Në njërën anë, këto dallime kulturore i ndajnë më tej serbët nga shqiptarët: rrjetet e klaneve shqiptare i qesin serbët në pozitë të papërshtatshme për shkak të levave të mëdha klienteliste në mes të familjeve në Kosovë. Sidoqoftë, në anën tjetër, rrjetet e jashtme të patronazhit serb krijojnë një nga ato pak rrethana ku serbët dhe shqiptarët e Kosovës nuk kanë problem të bashkëpunojnë: biznesmenët e pasur serbë që importojnë mallra ose materiale të ndaluara në Kosovë, punojnë me bandat shqiptare të krimit të organizuar për përfitime të dyanshme për të dy grupet.

Korrupsioni prek transaksionet në të gjitha nivelet, si në veri ashtu edhe në jug të Kosovës: vetëm disa projekte të infrastrukturës, në ndërtim, biznese të patundshmërisë ose ndihma të jashtme realizuar në mënyrë të pastër. Banorët i ngrisin supet ndaj këtyre veprimtarive, duke e ditur që nuk ka sundim të ligjit e as norma kulturore të mjaftueshme për të vepruar kundër kësaj dukurie. Përveç barrierave praktike ndaj investimeve të jashtme, kjo sjellje e ‘biznesit të zakonshëm’ përjetëson pabarazinë, i ulë aspiratat dhe i parandalon qytetarët për ta zhvilluar ndërmarrësinë—një nevojë për të hedhur në funksion ekonominë e Kosovës. Efekti neto është një strukturë e tensionuar sociale në të cilën të pasurit, njerëzit me lidhje dhe njerëzit e fuqishëm shfaqin ndikimet e tyre përtej kapaciteteve të Policisë, politikanëve dhe aktorëve të jashtëm, kryesisht për shkak se këta të fundit duhet të kenë lidhje këta të parët për të ushtruar veprimtarinë brenda Kosovës, në rend të parë.

ZVOGËLIMI I NDIHMAVE NGA JASHTË

Kosova është duke u ballafaquar me një krizë ekonomike në rritje: ndihma financiare nga jashtë dhe asistencë praktike që ajo ka pranuar nga viti 1999 do të zvogëlohet shumë më shpejtë se sa që do të stimulohet ekonomia, për të kompensuar këtë humbje. Në vitin 2008, kur Kosova shpalli pavarësinë e saj, donatorët ndërkombëtarë premtuan një ndihmë prej 1.2 miliard euro për periudhën 2009–2011.¹³ Evropa, donatori më i madh, ka rritur ndihmat vazhdimisht që nga viti 2011, duke alokuar 68.7 milionë euro në vitin 2011, 70 milionë euro në vitin 2012 dhe 71.4 milionë euro në vitin 2013.¹⁴ Shtetet e Bashkuara, donatori i dytë më i madh, ka alokuar 85.4 milionë dollarë në vitin 2011, 66.7 milionë dollarë në vitin 2012 dhe 57.6 milionë dollarë në vitin 2013.¹⁶ Restriksionet buxhetore të donatorëve, së bashku me pritjet që rubinetet e parave nuk mund të rrjedhin pafundësisht për Kosovën, tregojnë se trendi i zvogëlimit të ndihmave do të vazhdojë.

Përgatitja e planit për ndihmë të jashtme financiare mbështetet kryesisht në rekomandimet e Grupit Ndërkombëtar Udhëheqës. Por kur organi i saj administrativ, Zyra Civile Ndërkombëtare, e mbylli misionin e saj në Kosovë në vitin 2012 (një hap i konsideruar i nevojshëm për ta përgatitur Kosovën të qëndrojë në këmbët e veta) vëzhguesit nga Kosova që punonin në atë zyre u alarmuan nga fakti se shumë nga treguesit që përcaktojnë se çka është arritur dhe çka ende i nevojitet ekonomisë së Kosovës për të funksionuar – ishin të paqartë.

Ashtu siç qëndrojnë punët sot, Kosova ende pranon rreth 7.5% të GDP-së së saj nga programet e jashtme të ndihmës, dhe rreth 15% nga remitencat.¹⁷ Eksploatimi i resurseve natyrore përbën 60% të ekonomisë së Kosovës, ndërsa infrastruktura e saj industriale ka shumë nevojë për modernizim, por ka pak shpresa për investime për shkak të gjendjes në sundimin e ligjit dhe korrupsionit. Prospektet e punësimit, veçanërisht në një shtet ku 40% e të rinjve janë të papunë, vazhdojnë të përbëjnë një sfidë.¹⁸

Për t'i bërë problemet ekonomike të Kosovës edhe më të mëdha, raportohet se borxhi i Kosovës në fund të vitit 2013 ishte gati dyfish më i madh nga ai që ishte raportuar dy vite më parë. Kosova pranon hua nga bankat komerciale dhe institucionet financiare. Në vitin 2009, Kryeministri Thaçi raportoi se borxhi total i Kosovës është vetëm 249 milionë euro; në fund të vitit 2011 ishte 253 milionë euro. Për shkak të rritjes së konsiderueshme të borxhit të brendshëm gjatë vitit 2012 (73.3 milionë euro) dhe gjatë vitit 2013 (152.5 milionë euro), Thaçi llogariti borxhin publik të Kosovës në fund të vitit 2013 në 476 milionë euro.¹⁹ Nëse liderët e Kosovës—në bashkëpunim me njëri tjetrin, publikun e informuar dhe partnerët e jashtëm—nuk e ndryshojnë qasjen në adresimin e zbrazëtirave buxhetore në mënyrë radikale, Kosova do të ballafaqohet me probleme të mëdha ekonomike, të cilat akoma nuk është e gatshme t'i zgjidh.

MOSBALANCIMI TEJET I MADH NË TREGTI

Bazat ekonomike të Kosovës shërbejnë si tregues i efektshëm se ku lidhshipi i saj duhet të synojë përpjekjet. Në vitin 2012, Kosova ka eksportuar mallra dhe shërbime në shumë prej 270 milion Euro. Në dallim prej kësaj, importet ishin përafërsisht 2.5 miliardë Euro në vitin 2012, duke pasqyruar një prej mosbalancimeve më të këqija tregtare të import-eksportit në Evropë.²⁰

Nga totali i importeve, kategoria më e madhe e importit prej 21% përfshinë burimet minerare (shumica prej tyre në formë të lëndëve djegëse apo nën-produkteve). Ushqimi, pijet dhe ushqimet tjera përbëjnë kategorinë e dytë më të lartë të importit prej 12%. Pjesa tjetër ndahet në mes të importit të metaleve bazë, pajisjeve industriale dhe artikujve të tjerë.²¹

Që nga çereku i tretë i vitit 2013, mosbalancimi tregtar ka qenë pakëz i stabilizuar, duke shënuar një përmirësim të vogël: Deficiti i Kosovës në çerekun e dytë të vitit 2013 qëndroi në 147.6 milion Euro, duke përfaqësuar një rritje vjetore të deficitit tregtar prej 4.2%; megjithatë, deri në çerekun e tretë deficitit tregtar ka pasur rënie deri në 4.6%. Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, kjo ka qenë për shkak të uljes prej 3% të importeve gjatë çerekut të tretë të vitit 2013, me gjithsej prej 1.8 miliardë Euro. Eksportet kanë pasur rritje në çerekun e tretë të vitit 2013 prej 9.4%, në shumë prej 224 milion Euro.²²

Duke pasur parasysh vështirësitë unike të ekonomisë së Kosovës, rritjet e vogla si këto janë gjithmonë lajme të mira. Sidoqoftë, mbështetja shumë e madhe dhe e pamohueshme e Kosovës në import duhet të shikohet si një cak ndaj prioriteteve fiskale nëse dëshiron ta forcon pavarësinë e saj. Identifikimi i çaqeve në sektorin e industrisë së rëndë, duke shtuar këtu investimet në infrastrukturën teknike dhe kohën deri në aktivizimin e tyre, do të jetë i pamjaftueshëm edhe pse kjo mbetet fokusi i politikanëve. Pa i dhënë prioritet qasjeve më të hollësishme për të ndërtuar diturinë e shërbimeve ekonomike dhe duke i dhënë rëndësi strukturave financiare dhe nevojës për investimet në arsim, Kosova mund të vazhdojë të bëjë arritje të vogla afat-gjate në deficitin e saj tregtar duke rrezikuar të ardhmen e saj afat-gjate ekonomike.

4.4 Shtytësit socio-kulturor

TRASHËGIMIA NGA KONTROLLI SHTETËROR

Trashëgimia e Kosovës si pjesë e ish Jugosllavisë dhe lundrimi i saj në valët e sundimit komunist dhe socialist manifeston një mori të normave shoqërore. Aspekti më i fortë i kësaj trashëgimie është efekti psiko-social me implikime serioze në të ardhmen politike dhe ekonomike të Kosovës. Arsimimi, kujdesi shëndetësor dhe programet e mirëqenies sociale, si pensionet shtetërore, janë kuptuar nga Serbët dhe Shqiptarët që jetonin në ish-Jugosllavi si të drejta të tyre. Paternalizmi i strukturave shtetërore ka formësuar pritjet e publikut deri në një shkallë të caktuar ku edhe banorët shumë të rinj për ti mbajtur në mend vitet e paraluftës ose ata të cilët kërkojnë 'Jugonostalgjinë', flasin sot për të 'drejtat' e tyre të marrin ndihmat sociale për punësimin, arsimimin e lartë dhe kujdesin shëndetësor—një dallim i theksuar në krahasim me realitetin e shekullit 21 ku qytetarët e shteteve të tjera Europiane sot duhet të konfrontohen me to. Momentet kritike të ndjeshmërisë rreth pensioneve dhe pagesave të subvencioneve që Serbët e Kosovës presin që Serbia ti mirëmbajë (dhe burimi i politikave të kundërshtimit përmes së cilit liderët e Kosovës duhet të veprojnë) përfaqëson shembullin më të prekshëm të privilegjit popullor. Krijimi i shpejtë i shteteve të reja nga përmbysjet e luftërave Ballkanike iu ka marrë banorëve tranzicionin të cilat shtetet Europiane lindore e kanë kaluar derisa ata luftonin për të ndërtuar kontratat e reja pas-socialiste në ekonomi, politikë dhe shoqëri bazuar në vlerat liberale Europiane dhe të tregut të lirë.

Pasojat e këtij ndryshimi të lëkundur vazhdojnë të kenë efekt edhe sot: mosbesimi i publikut ndaj proceseve politike ka çuar drejt daljes së vogël të votuesve për të votuar; vëzhguesit i shikojnë mjetet e informimit si objekte që shërbejnë interesa të caktuara ose objekte propaganduese; dhe lloji i pavarësisë financiare që ndihmon krijimin e ndërmarrësisë—një parakusht i rëndësishëm për rritjen e ekonomisë së Kosovës—ka më pak përparësi se sa gjetja e një vendi të punës në ndonjë institucion publik. Politikanët Serb dhe Shqiptar e përjetësojnë këtë mentalitet nëpërmjet premtimeve elektorale për të mbështetur përfitimet nga mirëqenia dhe për të siguruar punësim dhe objektiva ekonomike të përealizueshme, të cilat tërhiqen nga këto premtime në momentin kur zgjidhen dhe kur realiteti financiar e shtrinë efektin e vet. E gjithë kjo e ruan një cikël të mosbesimit



Barrikada mbi urën kryesore në Mitrovicë sjell përkujtim për ndarjen me të cilën njerëzit në Mitrovicë kanë jetuar 14 vite.

publik dhe heqjes dorë e cila, së paku nëse nuk ndërpritet, do të mban Kosovën në një situatë pa rrugëdalje në aspektin ekonomik dhe politik.

EFEKET E BREZAVE

Kosova shumë shpejtë do të hyjë në vitin e katërt që kur barrikada është vendosur mbi urën e lumit Ibër. Barrikada, e vendosur nga Serbët etnik të Kosovës si shenjë proteste pasi njësitë e Policisë etnike Shqiptare të Kosovës janë munduar të marrin nën kontroll dy pikat kufitare administrative në qytetet veriore Jarinjë dhe Bërnjak në mesin e vitit 2011, tani ka rritje të bimëve në gjithë hapësirën e saj. Derisa kjo barrikadë ka mundur të bëjë matjen e ndarjes etnike të Kosovës me vite, ndarja faktike e të dyja komuniteteve tani mund të jetë llogaritur me dekada: janë bërë 14 vite që kur Serbët e Kosovës kanë ikur në veri dhe shumica e Shqiptarëve të Kosovës kanë ikur nga veriu në jug pasi shtëpitë e tyre dhe bizneset janë djegur dhe rrafshuar si rezultat i fushatës ajrore të NATO-s të vitit 1999. Për shumë qytetarë, ura përfaqëson një vijë ndarëse që kurrë nuk mund të kalohet. Në kushtet praktike, ura dhe barrikada e saj kanë krijuar një periudhë të gjatë të ndarjes së një gjenerate të tërë të cilëve mbetet socio-kulturorë shfaqen te rinia e veriut të Kosovës.

Rritja e madhe e të rinjve në Kosovë është domethënëse: nga popullata e saj prej 1.8 milion banorë, gati gjysma e saj janë me moshë më të re se 25 vjet. Në vend se rinia të shërbej si përparësi për një brez të ri të shkëputur nga e kaluara jo e lumtur e Kosovës, demografia e tillë është duke rrëshqitur thellë në greminën e saj. Kushtet e papunësisë për këtë grup janë më të këqijat në Evropë: vlerësimet sugjerojnë se 73% të qytetarëve me moshë të punës nën moshën 24 vjeçare janë të papunësuar dhe shpresat e tashme sugjerojnë se ky trend është duke shkuar drejt rënies. Nga 30,000 të rinj që kërkojnë punë në baza vjetore, më pak se 8,000 prej tyre gjejnë ndonjë punë.²³

Duke u ndërlidhur me punësimin, Serbët etnik të Kosovës ballafaqohen me shumë pengesa si pakicë. Gjuha dhe kultura e tyre ende nuk po përfaqësohen në mënyrë adekuate, dhe kushtet e arsimimit janë shumë të vështira. Akreditimi i diplomave në Kosovë është neglizhuar. Shumë të rinj Serbë ngjallin frikë për atë që ata presin kur e 'kalojnë urën' ose kur vijnë në kontakt me Shqiptarët etnik, edhe pse përvoja e tyre personale, me rastin e takimeve aktuale me shqiptarë, është paqësore. Ndikimi i prindërve mbi fëmijët, veçanërisht kur familjet etnike Serbe kanë përjetuar humbje gjatë luftës, mund të përjetësojnë stereotipe dhe shqetësime. Ky ndikim rritet përmes mesazheve politike dhe mjeteve të informimit nga Serbia, e cila rezulton me mosdashjen e banorëve të rinj ti besojnë përvojave të tyre personale. Disa aktivitete përmes të cilave të rinjtë mund të fuqizojnë energjinë e tyre, përveç angazhimeve në punë dhe studime, janë klubet sportive banditeske që stimulojnë dhunë përmes sloganeve nacionaliste, i mundësojnë të rinjve të rrisin frustrimin e tyre në mënyra destruktive kundër atyre që ata i shohin si tiranë të tyre.

Pa pasur perspektivë për punësim dhe arsimim cilësor që mund të plotëson përvojën e tyre, mungesa e shpresës dhe besimit ka zënë vend në mes të rinjve. Shumë Serb etnik planifikojnë ta lënë Kosovën sa më shpejtë që është e mundur, se sa të bëjnë përpjekje të ndërtojnë një mjedis që e shohin si geto ku shanset e tyre për të ardhme të mirë janë fizikisht të rrethuara nga bllokadat rrugore dhe barrikatadat. Por këta Serbë mund të jenë të papërgatitur të merren me faktin se, nëse ikin, ajo që i pret ata atje së paku nuk është medoemos më e mirë se sa ajo çka kanë lënë ata mbrapa.

SHFAQJA E FUNDAMENTALIZMIT

Të thuash se Kosova po talebanizohet, sic kanë deklaruar disa media konservatore Perëndimore, është paranoike dhe e tepruar. Edhe pse 95% e popullatës e identifikojnë veten si myslimanë, shumica e myslimanëve shqiptarë (por edhe e boshnjakëve, turqve dhe pakicave tjera etnike) i janë përshtatur sekularizmit kushtetues sipas të cilit feja është e ndarë nga qeverisja. Historikisht, kur bëhet fjalë për manifestimin e fesë në shoqëri, bashkësitë islame të Kosovës janë më shumë të lidhura me Perëndimin se sa me Lindjen e Mesme ose Azinë. Sidoqoftë, në Kosovë po shfaqen shenjat e para të fundamentalizmit dhe atë në vendet si Komuna jugore e Mitrovicës dhe disa vende tjera.

Aktivistët e kanë përhapur influencën islamike në Kosovë duke vepruar përmes tri fushave kryesore në të cilat bazohet drejtimi salafist: ndihmat humanitare për rindërtim, trajnimi i imamëve dhe shpërndarja e literaturës. Një nga donatorët kryesor ndërkombëtarë që ka ndihmuar në rindërtimin e xhamive dhe shkollave të shkatërruara gjatë luftës në Kosovë ishte Komiteti i Bashkuar Saudit për Rindërtimin e Kosovës dhe Çeçenisë (SJCRC). Vehabistët e Arabisë Saudite janë të lidhur shumë lëvizje militante islamike. Në zonat më të largëta të Kosovës, ku komuniteti ndërkombëtar u tregua më i gatshëm t'ua besojë punët rreth rindërtimit organizatave me orientime fetare si SJCRC-së, mësimi vehabist dhe shpërndarja e literaturës fetare u lejua të lulëzojë pa asnjë kontroll.²⁴

Lëvizja Islame "Bashkohu" e Kosovës (LISBA), një parti politike islamike, zyrtarisht e regjistruar në vitin 2013, është duke u rritur. LISBA synon të tërheq gjeneratat e reja të të rinjve myslimanë të Kosovës: të pakënaqurve, të papunëve dhe atyre nga zonat më të largëta të vendit, ku Arabia Saudite dhe Katari investuan në rindërtimin e shkollave dhe xhamive të shkatërruara nga lufta, çka mundësoi përhapjen e mësimave fundamentaliste në komunitetet që më parë ishin të moderuara. LISBA ka nisur një luftë fjalësh përmes rrjeteve shoqërore (në veçanti përmes Facebookut), gjë që ka shqetësuar shumicën e myslimanëve sekular të cilët kanë marrë qëndrime



Prizren/Prizren në jug të Kosovës; shumica e Myslimanëve në Kosovë përkrahin sekularizmin (laicizmin).

të forta opozitare duke kundërshtuar edhe Bashkësinë Islame të Kosovës (BIK) si institucionin me më ndikim dheme pikëpamje politike dhe sociale të moderuar. LISBA e ka ngritur temperaturën në disa çështje të ndryshme. Në vitin 2014, LISBA keqinterpretoi një propozim të Kuvendit për uljen e zërit të ezanit (thirrjes myslimane për falje) e cila kishte për qëllim të përshtat zhurmën e ambientit me standardet e BE-së, e cila u interpretua si përpjekje për ta ndaluar ezanin—një fushatë e dezinformimit, që kishte për qëllim manipulimin e opinionit publik që ta drejtojë atë kundër këtij propozimi por dhe kundër BIK-ut, që punoi me Ministrinë e Mjedisit të Kosovës për të krijuar një projekt-ligj dhe për të vendosur standardet e transmetimit automatik të ezanit.²⁵ Edhe pse fundamentalizmi është shumë jopopullor brenda shumicës myslimane të Kosovës dhe LISBA ende mbetet një forcë e parëndësishme politike, aftësia e saj për të tërhequr vëmendje përmes provokimeve në një ambient ku mjetet e informimit nuk janë të sofistikuar dhe ku njerëzit kërkojnë rrugëdalje nga frustrimet e tyre, nuk duhet neglizhuar dhe veprimet e saj duhet të përcillen me kujdes. Pa një përpjekje të konsoliduar nga liderët politikë kosovarë dhe partnerët e tyre ndërkombëtar për përforcimin e sekularizmit kushtetues, ekziston rreziku i paraqitjes së tensioneve ndëretnike, kësaj here të nxitura nga ideologjitë sektare dhe dhuna e financuar globalisht, që ato shpeshherë sjellin. ♦

5. Çështjet kryesore

B anorët e Rësovës në jetën e tyre të përditshme ballafaqohen me sfida të mëdha. Shërbimet publike themelore si uji i pijshëm, menaxhimi i mbeturinave dhe furnizimi i pandërprerë me rrymë nuk janë në nivel. Shërbimi shëndetësor është një shembull tjetër: mungesa e qasjes në përkujdesje shëndetësore cilësore i shtyn njerëzit të kërkojnë alternativa tjera si për shembull në Shqipëri dhe Serbi. Disa shqiptarë nga jugu i Rësovës kalojnë pa zhurmë lumin Ibër për të kërkuar trajtim nga mjekët të cilëve ata iu besojnë në qytetet me shumicë serbe, në veri të Rësovës. Megjithatë, kushtet në veri nuk janë domdoshmërisht më të mira. Raportet jozyrtare flasin për rritje të rasteve të sëmundjeve të kancerit, sidomos të kancerit në mushkëri, zorrë të trashë, gji dhe në ovare. Rështu të paktën pohojnë mjekët të cilët punojnë në veri të Rësovës dhe që trajtojnë pacientë si nga jugu ashtu dhe veriu.²⁶ Në mungesë të laboratorëve për t'i përcaktuar në mënyrë shkencore shkaqet e këtyre dukurive, mjekët mund vetëm të spekulojnë se stresi dhe ekspozimi ndaj toksinave të ambientit (përfshirë uraniumin e varfëruar në armatimin e përdorur nga forcat e NATO-së gjatë fushatës së bombardimeve të vitit 1999) janë ndër shkaktarët e mundshëm.²⁷ Përkundër kushteve të këqija, si mjekët ashtu edhe mësuesit kanë vënë re një rritje në shkallën e lindjeve mes serbëve të Rësovës.²⁸

E ardhmja e veriut do të ndikohet në masë të madhe nga shkalla e zhvillimit në disa fusha kyçe në veriun e Kosovës, por gjithashtu edhe në tërë Kosovën dhe më gjerë në rajon. Në tekstin në vijim kemi dhënë një përshkrim të shkurtër të gjendjes në disa nga sektorët më të rëndësishëm të cilat me gjasë do të kenë ndikimin më të madh në të ardhmen e komunave veriore të Kosovës:



Mjekët duke punuar në spital në veriun e Mitrovicës kanë konstatuar një rritje të shkallës së lindjes të Serbëve të Kosovës.

5.1 Uji

Pas luftës së vitit 1999, një pjesë e madhe e infrastrukturës së ujësjellësit në Kosovë ishte e cilësisë së dobët. Sot, furnizimi me ujë të pijshëm dhe infrastruktura e kanalizimeve mbesin sfidat më akute (në kuadër të shërbimeve publike) me të cilat ballafaqohen banorët. Rezervuari më i madh është liqeni i Gazivodës, i cili e furnizon me ujë të pijshëm pjesën më të mëdha të Kosovës si dhe dy termocentralet, Kosovën A dhe B, që gjenden në afërsi të Prishtinës. Pjesa më e madhe e Liqenit të Gazivodës gjendet në komunën me shumicë serbe të Zubin Potokut, kurse një pjesë e liqenit është në territorin serb, që e bënë Kosovën të varur nga Serbia për furnizim me ujë të pijshëm.

Kjo vartësi shtrihet edhe në aranzhimet e brendshme që kanë të bëjnë me furnizim me ujë: furnizimi me ujë të pijshëm i komunave veriore të Zveçanit dhe Komunës veriore të Mitrovicës fillon nga Zubin Potoku kalon nëpër Komunën jugore të Mitrovicës (deri te fabrika e ujit në Shipol) prej nga uji i përpunuar kthehet në veri. Si pasojë, furnizimi me ujë të pijshëm i komunës së Zveçanit dhe Komunës Veriore të Mitrovicës, me shumicë serbe, varet nga komuna jugore e Mitrovicës, me shumicë shqiptare. Pavarësisht këtyre ndërvarësive në furnizim me ujë të pijshëm, kërkesat për ujë i tejkalojnë mundësitë e furnizimit, për këtë arsye njerëzit në veri dhe jug të Kosovës kanë jetuar për vite me radhë duke kursyer ujin. Si pasojë e ndryshimeve klimatike janë zvogëluar të reshurat që kontribuojnë në mbushjen e tri rezervuarëve kryesorë të Kosovës. Sasia e ujit në basenin e Badovcit është vlerësuar të jetë e pamjaftueshme. Si rrjedhojë, mungesa e ujit është e shprehur veçmas në rajonin e Prishtinës.²⁹



Liqeni Ujmani (Gazivoda) në Zubin Potok në veri të Kosovës është rezervuari kryesor i ujit për Kosovë.

Sfidat që lidhen me furnizimin me ujë të pijshëm përfshijnë sasinë e përgjithshme të ujit në dispozicion, integritetin dhe gjendjen e sistemit të gypave (bartja e ujit nëpër gypa po rezultojnë me humbje të mëdha për shkak të rrjedhjeve) si dhe cilësinë e ujit të pijshëm.³⁰ Rekonstrukcioni i ujësjellësit po trajtohet si investim me prioritet nga donatorët e BE-së, përmes instrumenteve të tyre të financimit, por bie në sy një investim shumë i vogël në infrastrukturën e ujësjellësit nga Qeveria e Kosovës.³¹ Përkundër përpjekjeve të BE-së për ta përmirësuar gjendjen në furnizimin me ujë të pijshëm, sektori i ujit në Kosovë vazhdon të vuajë mungesën e investimeve edhe për shkak të mungesës së vullnetit politik të qeverisë: ajo ka dështuar ta bëjë çështjen e ujit prioritet të investimeve dhe nuk ka personel e as aftësit eknike brenda institucioneve të saj. Kosova mbetet shumë larg nga plotësimi i standardeve të BE-së për menaxhimin e ujit dhe burimeve të ujit. Sipas vlerësimeve të BE-së, Kosovës do t'i duhet të investojë minimum 60 milionë euro në vit për dhjetë vitet e ardhshme në mënyrë që të paktën t'i afrohet plotësimi të këtij standardi.³² Nëse këto shërbime elementare nuk zgjidhen në të ardhmen, Kosova rrezikon të ballafaqohet me trazira. Meqenëse burimi më i madh i ujit gjendet në veri të Kosovës dhe i njëjti ndahet me Serbinë, këto probleme mund të ndikojnë në marrëdhëniet ndëretnike dhe raportet ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

5.2 Rryma

Kosova gati në tërësi varet nga djegia e thëngjillit për prodhimin e rrymës. Rryma elektrike në Kosovë gjenerohet nga linjiti, lloji më i papastër i thëngjillit që përdoret për djegie, me të cilin Kosova është e pasur; Prishtina, ku ekonomia varet me të madhe nga nxjerrja e thëngjillit dhe burimeve të ngjashme, është gjithashtu zona ku ndodhen termocentralet kryesore, Kosova A (e cila planifikohet të mbyllet pas ndërtimit të termocentralit të ri, proces ky që po zvarritet me vite) dhe Kosova B.

Të dy termocentralet së bashku nuk prodhojnë sasi të mjaftueshme të energjisë elektrike për tërë Kosovën; restriktionet e rrymës janë të shpeshta dhe paraqesin pengesë për rritjen ekonomike, e cila varet nga furnizimi i rregullt me energji elektrike. Banorët në veri të Kosovës furnizohen me rrymë nga Elektro-ekonomia e Serbisë përmes trafostacionit të Vallaqit, i cili ishte në menaxhimin e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) deri në vitin 2009, kur këtë e mori Elektromreža Srbije (që operon me rrjetin e transmisionit të Serbisë) me pretekstin e sigurimit të rrymës për serbët e Kosovës - një shembull tjetër i ndarjeve veri-jug të Kosovës. Negociatat e vitit 2013 rezultuan me një marrëveshje për t'ia kthyer KOSTT-it (operatori i tanishëm i rrjetit të transmisionit) kontrollin mbi trafo-stacionin e Vallaqit dhe për t'i lejuar Kompanisë për Energji Elektrike të Serbisë të themelojë një kompani në Kosovë, sipas ligjeve të Kosovës dhe administratës tatimore, duke mundësuar në këtë mënyrë një marrëveshje me KOSTT-in dhe Kompanisë për Distribuim dhe Furnizim me Energji (KEDS) që të furnizojnë me rrymë elektrike konsumatorët në veri të Kosovës.³³

KEK-u, si prodhuesi, shpërndarësi dhe furnizuesi kryesor i rrymës në Kosovë, nuk ka ndonjë reputacion të mirë në furnizimin me rrymë dhe konsiderohet si një nga organizatat më të korruptuara në Kosovë.³⁴ Që nga përfundimi i luftës në KEK janë investuar më shumë se 500 milionë euro, përderisa vlerësohet se ai ka një qarkullim prej mbi 1 miliard eurosh, kurse 550 milionë euro tjera janë alokuar për më shumë se 500 tenderë që nga viti 2007. Disa nga këto tenderë janë hetuar nga BE-ja, meqenëse dyshohet se paratë shkojnë në duart e anëtarëve të njohur si 'Mafia Energjetike e Ballkanit'.³⁵ Në vitin 2013, Qeveria e Kosovës i privatizoi degët e transmisionit dhe shpërndarjes së rrymës. Kohëve të fundit, konsumatorët kosovarë të energjisë kanë mësuar se KEDS-i i përmendur më lartë (pronë e Kompanisë Turke Calik & Limak, e cila ka privatizuar Distribucionin e KEK-ut) ka përdorur njehsorët digjital të kurdisur për të tarifuar energjinë e pashfrytëzuar - një fakt i zbuluar nga Ministria e Tregtisë, por që nuk është bërë publike. Që nga ajo kohë është ndërprerë shpërndarja e njehsorëve digjital, por shumë prej tyre janë ende aktive në tërë Kosovën.³⁶ Çka është interesante, kompanitë serbe kanë përfituar më së shumti nga KEK-u. Madje edhe në fushat ku KEK-u mund të furnizojë me energji të mjaftueshme, ajo ishte e obliguar t'i përmbush kontratat me kompanitë serbe të energjisë, të cilat importojnë energji në Kosovë me çmime dukshëm më të larta - që përbën një rast interesant të bashkëpunimit serbo-kosovar, ku një bashkëpunim i tillë, edhe pse do të ishte i paqëndrueshëm në sferën politike, duket shumë i natyrshëm kur bëhet fjalë për përfitime të paligjshme.³⁷

5.3 Arsimi

Sikur edhe shumë fusha të tjera të jetës edhe arsimi në Kosovë është i ndarë. Ekzistojnë dy sisteme arsimore paralele: ai serb dhe kosovar. Të gjitha komunitetet në Kosovë ballafaqohen me probleme të shumta në sektorin e arsimit. Këto probleme sillen nga mungesa në dispozicion e opsioneve parashkollore, vijimi i mësimin në ndërtesat dhe objektet shkollorë dy ndërrime, akreditimi i pasigurt e deri te mungesa e numri të mjaftueshëm të mësimitdhënësve të kualifikuar.

Këto probleme janë identifikuar në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, nga ai parashkollor e deri te arsimi i lartë.³⁸ Mësimdhënia në dy gjuhë nuk është pjesë e asnjë kurrikule të obligueshme në Kosovë; mungesa e personelit, e investimeve dhe vullnetit politik e pengojnë zhvillimin e arsimit, edhe pse të gjithë e njohin rolin që ka shkollimi për të ardhmen ekonomike dhe shoqërore të Kosovës. Arsimi i lartë ka treguar prirje për korrupsion: raportet për fabrikimin e punimeve shkencore nga rektori i universitetit në fillim të vitit 2014, nxitën protestat e studentëve që rezultuan me dorëheqjen e tij. Përkundër këtij suksesi, studentët paralajmëruan se do ta

vazhdojnë luftën e tyre për më shumë transparencë dhe më pak korrupsion brenda sistemit universitar.³⁹

Në veri të Kosovës nxënësit mësojnë sipas sistemit arsimor serb - ndonëse ka pjesëtarë të komunitetit shqiptarë që i vijnë mësimet në bazë të planprogrameve të Kosovës. Mësimdhënësit dhe prindërit e kundërshtojnë integrimin e mundshëm të arsimit në sistemin kosovar. Ata thonë se arsimi kosovar është jokualitativ dhe ka paqartësi sa i përket reformimit të kurrikulës dhe akreditimit të diplomave. Serbët përmendin frikën e integritit të sistemit arsimor serb në atë kosovar si një nga arsyt kryesore për t'u larguar nga veriu i Kosovës; ata brengosen se fëmijët e tyre nuk do të mësojnë më për historinë dhe kulturën serbe. Lënda e edukatës qytetare, shumë e nevojshme për ndryshimin e ambientit shoqëror pas-konfliktit, në shkollat serbe është opsionale, si alternativë ndaj lëndës së religjionit.⁴⁰ Dëmet e pasluftës dhe zhvendosjet e brendshme të njerëzve e kanë detyruar komunitetin shqiptar në disa zona të veriut të ndërtojnë shkollat në formë kontejnerësh, ku furnizimet me materiale shkollore dhe hapësira për rekreacion janë tërësisht inekzistente.

Universiteti në Komunën veriore të Mitrovicës (Universiteti i Prishtinës përkohësisht i vendosur në Mitrovicë) është shumë i rëndësishëm për Serbët. Brengat për plan-programet arsimore dhe akreditimin e diplomave janë të zakonshme, por serbët gjithashtu shprehen të shqetësuar se në ç'masë Universiteti i tyre do të mbetet atraktiv për studentët nga Serbia ose shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor. Për momentin, studentët që vijnë në Komunën veriore të Mitrovicës marrin bursa të mira; prezenca e tyre ndikon në ekonominë vendore si dhe në atmosferën shoqërore në veri. Serbët ndoshta nuk e dëshirojnë diplomën e Universitetit të Kosovës për vete dhe fëmijët e tyre, por ata gjithashtu nuk duan ta humbin fluksin e studentëve. Shumë nga studentët që studiojnë këtu nuk do të jenë në gjendje të gjejnë punë me këto diploma në vendet e tyre. Serbia dhe Kosova kanë arritur marrëveshje për akreditimin e diplomave qysh në vitin 2011, por detajet nga kjo marrëveshje dhe implementimi i saj nuk janë të njohura për publikun, e as për personelin universitar.

Është me rëndësi të thuhet se përmirësimet në sistemin arsimor do të jenë të kota nëse nuk rriten kapacitetet e punësimit në Kosovë. Një zyrtar i universitetit të Komunës veriore të Mitrovicës ka thënë: "Unë po përgatis kamerierë".⁴¹ Investimet më urgjente në infrastrukturë do të kërkojnë punëtorë të aftë teknik, të aftësuar në fushat e ndryshme të industrisë apo makinerisë që kanë mbetur të shkatërruara pas lufte. Mundësitë e tashme për shkollim dhe punësim fare nuk përputhen - një fakt që mban gjallë rrethin vicioz të njerëzve të rinj shumë të shkolluar por të papunë, të cilët nuk mund t'i përshtatin aftësitë e tyre në fushat ku ka më së shumti mundësi punësimi.

5.4 Mjetet e informimit dhe telekomunikacioni

Jetëgjatësia e problemeve më shkatërrimtare të Kosovës është rritur nga mungesa e informatave objektive dhe të verifikueshme të cilat publikohen në mediet e pavarura dhe të besueshme. Struktura e ndarë e komuniteteve serbe dhe shqiptare dhe interesat e ndryshme dhe dallimet gjuhësore pengojnë përhapjen e shërbimeve mediale që mund t'iu shërbejnë të gjitha komuniteteve në Kosovë në mënyrën ekonomikisht të favorshme. Banorët e veriut të Kosovës kanë mundësi t'i shikojnë kanalet serbe (RTS, TV Prva dhe B92), televizionet lokale (Most dhe Mir) dhe kanalet ndërkombëtare (siç janë CNN, BBC dhe Al Jazeera). Mbulimi në lajme i çështjeve të rëndësishme në nivel lokal, megjithatë, është i papërfillshëm. Ndikimi



Prezenca e studentëve në universitet në veri të Mitrovicës ka ndikim pozitiv në ekonominë vendore dhe në atmosferën shoqërore në qytet.

politik edhe këtu luan një rol: disa shtëpi mediale në gjuhën serbe në Kosovë janë në pronësi dhe menaxhohen nga konglomeratët nga Serbia, të cilët shpesh kanë lidhje të drejtpërdrejta me partitë politike ose politikanët. Një numër i serbëve e kuptojnë se mjetet e tilla të informimit janë të censuruara. Sidoqoftë, -edhe media lokale është po ashtu e dëmtuar: informatat nga burime të besueshme është vështirë të mblidhen; sigurimi i fondeve për gazetarinë hulumtuuese vendore është detyrë e vështirë; lajmet e ndjeshme lokale përbëjnë rrezik për sigurinë e gazetarëve gjersa presioni dhe dhuna kundër korrespondentëve për shkak të publikimit të ndonjë informate të papërshtatshme, kalojnë pa u dënuar. Si rrjedhojë, shumë persona që mbledhin informata në Kosovë e censurojnë vetveten.⁴² Raportet për vet-censurim, si në mesin e gazetarëve ashtu edhe te banorët e veriut, janë rritur dukshëm që nga fillimi i dialogut ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

Kultura alternative e informimit që dominon në veri të Kosovës transmetohet përmes rrjeteve jo formale të miqve të besuar, familjeve dhe internetit (në shembullin e dytë shpërndarja e informacionit më së shumti bëhet përmes rrjeteve sociale dhe portaleve mediale⁴³). Kur iu është shtruar pyetja një fokus grupi të të rinjve serbë nga veriu i Kosovës se ku informohen për zhvillimet lokale, shumica prej tyre e drejtojnë gishtin te një nga personat e intervistuar, sepse motra e tij është e njohur për vetë-publikimin në një faqe të famshme në Facebook, ku publikohen ngjarjet lokale në Komunën veriore të Mitrovicës dhe në vende tjera.

Politizimi është zgjeruar edhe në fushën e telekomunikacionit. Ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit ka pasur shumë pazarllëqe politike në lidhje me ofrimin e shërbimeve në Kosovë nga operatorët

serbë, duke përfshirë edhe kodin telefonik ndërkombëtar treshifror. Në shtator të vitit 2013 u arrit një marrëveshje për kodin telefonik të Kosovës si dhe u lejuan operatorët serbë të vazhdojnë më ofrimin e shërbimeve të tyre në veri të Kosovës. Por, sikurse edhe shumë marrëveshje tjera në parim ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, detaje akoma duhet të negociohen dhe të finalizohen. Mes pikave më të ndjeshme dhe të kontestueshme është fakti se Kosova nuk është anëtare e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit, një parakusht për të aplikuar për kodin telefonik ndërkombëtar treshifror (+383 në rastin e Kosovës).

5.5 Ìndustria e rëndë

Ekonomia dhe historia e Kosovës gjithmonë kanë qenë të lidhura në me minierat dhe metalurgjinë, nga ku rezulton pjesa dërmuese e eksportit të industrisë së rëndë. Nga kompleksi i minierave të Trepçës që shtrihet në jug dhe në veri të Mitrovicës që nga fillimi i shekullit 20 eksploatohet thëngjilli, plumbi, argjendi, zinku dhe ari. Në kulmin e prodhimitarisë Trepça punësonte 23.000 njerëz në Kosovë dhe kontribuonte me rreth 70% të bruto produktit të brendshëm (GDP).⁴⁴

Që nga përfundimi luftës së vitit 1999 prodhimtaria në miniera asnjëherë nuk ka arritur nivelet e paraluftës. Infrastruktura e minierës është dëmtuar pas lufte si pasojë e neglizhencës. Sipas ish inxhinierëve të fabrikës aktivizimi i minierës si biznes i qëndrueshëm kërkon shpimin e së paku një miniere të re si dhe hapjen e portës për hyrje në të.⁴⁵ Vlerësimet e shpenzimeve të nevojshme për të riparuar dhe investuar në shkretoret dhe rafineritë e reja, të mjaftueshme për të sjellë prodhimitarinë në nivelet minimale, vlerësohen në minimum 650 milionë dollarë.⁴⁶ Në ndërkohë, në veri të Kosovës po përhapen thashetheme se kompleksi i Trepçës në pjesën veriore të Mitrovicës është blerë nga një konsorcium i dyshimtë, me ndihmën e Shteteve të Bashkuara, dhe se ata do të kryejnë shpime të pjerrëta nga Serbia në damarët e xeherores, si mënyrë për t'iu shmangur pengesave ligjore për krijimin e një kompanie në Mitrovicë, ku juridiksioni mbi regjistrimin e bizneseve mbetet tërësisht i paqartë. E vërteta është se ekziston një marrëveshje e vitit 2013 në mes një kompanie Amerikane me seli në Çikago, Illinois, e njohur si New Generation Power SH.P.K, dhe Serbisë, e cila ka rezultuar me përpilimi e një studimi të fizibilitetit të minierës nga kompania New Generation Poweru.⁴⁷

Shkretorja e Ferronikelit dhe komplekset e minierave të thëngjillit në jug, përreth Prishtinës, së bashku me kompleksin e Trepçës, përbëjnë pjesën më të madhe të industrisë së rëndë që ka mbetur aktive. Përveç mungesës së investimeve dhe problemeve me riparimet e pasluftës me të cilat ballafaqohen minierat dhe shkretoret, problemi si pasojë e mbeturinave dhe ndotjes që ato e shkaktojnë është akoma më i rënda. Djegia e linjtit liron gati 1.6 milion ton të hirit toksik brenda një viti ⁴⁸ dhe ndërsa veprimtaria e minierës së Trepçës ka gjeneruar një mbetje industriale të pa trajtuar të llumit në Mitrovicë nga e cila rrjedhin kemikalie toksike në ujin tokësor dhe në tokë, si dhe drejtpërsëdrejti në lumin Ibër.⁴⁹ Për shkak të mosinteresimit dhe mungesës së investimeve në menaxhimin e mbeturinave publike dhe industriale, shëndeti publik i banorëve të këtyre lokacioneve me gjasë do të keqësohet sidomos në komunat veriore dhe jugore të Mitrovicës, në Zveçan dhe në zonat përreth Prishtinës, përderisa 'haraçin' e ndotësve do ta paguajë popullata dhe toka e punueshme bujqësore. ♦



© Peshkulli Bana

Një grumbull i përkohshëm i mbeturinave në bregun e lumit Ibër në veri të Mitrovicës derdhet në lum; kushtet e shëndetit publik mund të përkeqësohen nëse menaxhimi i mbeturinave rezidenciale dhe industriale mbetet pa zgjidhje.

6.

Përfundimi

Qëllimi i skenarëve të krijuar në këtë raport është t'iu mundësojë vendimmarrësve të hartojnë politika që marrin parasysh sa më shumë opsione që është e mundur. Gjithashtu, skenarët iu mundësojnë njerëzve të jenë më të informuar për të ardhmen e tyre. Asnjë skenar nuk është superior ndaj tjerëve. Një interpretim i tillë do të ishte i padrejtë në raport me diversitetin e këndvështrimeve të njerëzve të konsultuar në këtë raport. Skenarët nuk janë as prognoza e as parashikime lineare të një të ardhmeje; e ardhmja reale me gjasë do të ketë elementet e të katër skenarëve. Hartuesit e politikës kosovare dhe serbe, komuniteti ndërkombëtar dhe aktorët nga shoqëria civile e të gjitha komuniteteve duhet të tregojnë përkushtim, të bëjnë përpjekje dhe të kenë vullnetin e mirë për t'i shmangur disa ndikime negative të këtyre skenarëve, me qëllim që ta bëjnë veriun e Kosovës një vend më të mirë për të jetuar në vitin 2020. Rekomandimet e marra në nivel lokal të prezantuara pas Përmbledhjes ekzekutive ofrojnë sugjerime se si të arrihet kjo.

Kusht për përmirësimin e kualitetit të jetës së të gjithë njerëzve që jetojnë në veri të Kosovës dhe më gjerë është që marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të jenë të qëndrueshme dhe Kosova t'i pranojë të gjitha komunitetet dhe t'i trajtojë ato me respekt. Këto sfida janë të ndërlidhura mes vete: për pranimin dhe respektimin e të gjitha komuniteteve kërkohet sundimi i ligjit, qeverisja e mirë, mundësia e punësimit dhe pajtimi mes komuniteteve. Përmirësimi i raporteve Kosovë-Serbi kërkon tejkalimin e shumë çështjeve të dhembshme nga e kaluara dhe kontakte me komunitetin serb të Kosovës, e cila menjëherë perceptohet sikur po bëhen shumë lëshime nga komuniteti shqiptar i Kosovës.

Autorët e këtij raporti dëshirojnë të theksojnë një vërejtje dhe rekomandim: komuniteti -serb në veri të Kosovës ka nevojë për një proces të kujdesshëm, përsëritës dhe konsultues për të

përcaktuar pozitën e tij. Mes komunitetit shqiptar të Kosovës ka lëshuar rrënjë pakënaqësia dhe mungesa e durimit që ndjehen fuqishëm për shkak të mungesës së përparimeve në shumë fusha. Problemet më të mëdha janë korrupsioni i nivelit të lartë, mungesa e mundësive ekonomike, statusi i papërfunduar i Kosovës dhe pasojat e tij si dhe ndjenja shumë e përhapur se Qeveria e Kosovës po bën lëshime të njëanshme ndaj Serbisë. Pakënaqësia ka arritur në ato nivele sa që edhe gjërat e vogla mund të nxisin trazira popullore, duke rrezikuar zhvillimet pozitive në raport me veriun. Prandaj, përpjekjet nuk duhet të drejtohen vetëm në veri të Kosovës ose të fokusohen vetëm te komuniteti serb, por të zhvillohen në mënyrë sistematike edhe në pjesët e tjera të Kosovës. Gjëja më e rëndësishme është se interesat e një bashkësie nuk guxojnë të sakrifikohen për llogari të bashkësisë tjetër. ♦

Fusnotat

- 1 Në këtë raport, jugu i Kosovës referohet territorit në jug të lumit Ibër.
- 2 Në kohën e përgatitjes së këtij raporti gjykatat serbe zgjidhnin vetëm rastet urgjente civile (divorcet, përkujdesi ndaj fëmijut).
- 3 Fokus Grupi, Graçanicë, 26 janar, 2014
- 4 Fokus Grupi, Komuna veriore e Mitrovicës, 23 janar, 2014
- 5 Intervista me zyrtarë të EULEX-it, OSBE-së në Komunën veriore të Mitrovicës dhe Prishtinë, dhe me disa grupe të fokusit në Komunën jugore të Mitrovicës, 23–27 janar 2014
- 6 Intervista të ndryshme në komunat veri dhe jug të Mitrovicës, 23–27 janar 2014
- 7 Teknikalitet e shumta ligjore me të cilat ballafaqohet Kosova dhe Serbia sa i përket implementimit të Asociacionit të Komunave Serbe janë renditur me bollëk nga Ilir Deda dhe Ariana Qosaj-Mustafa në dokumentin e tyre të publikuar në korrik 2013 për KIPRED, Deda, I; Qosaj-Mustafa, A (2013) Implementimi i marrëveshjeve të Dialogut Politik Kosovë-Serbi. Dokumenti Politik i KIPRED-it Nr.4/13, http://www.kipred.org/advCms/documents/22356_The_Implementation_of_Agreements_of_Political_Dialogue.pdf (24 Maj 2014)
- 8 Qendra Evropiane për Monitorimin e Drogave dhe Drogimit dhe Raporti i tregjeve të drogës në BE nga EUROPOL (2013): një analizë strategjike, <https://www.europol.europa.eu/sites/default/files/publications/att-194336-en-td3112366enc-final2.pdf>, (10 Tetor 2013)
- 9 Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krime (2011) Raporti për analizën e gjendjes së së drogës në Evropën Juglindore, <http://www.msb.gov.ba/dokumenti/DSAR.SEE.published.pdf> (22 Korrik 2013)
- 10 Organizata për Kombet dhe Njerëzit e Papërfaqësuar (2014) Kosova: Qëllimet për të themeluar një armatë të kontestuar nga Serbia, <http://www.unpo.org/article/16936>, (12 Mars 2014)
- 11 Informatat e vërtetuara nga intervistat me zyrtarët e Policisë së Kosovës si dhe me agjencitë ndërkombëtare të sigurisë, Komuna veriore e Mitrovicës, 23–24 Janar 2014
- 12 Wiese, J (2012) 'In Kosovo, bashkësia ndërkombëtare planifikon të ndërrojë rolin.' *Devex*, 15 Tetor 2012, <https://www.devex.com/news/in-kosovo-international-community-looks-to-shift-role-79446> (20 Shtator 2013)
- 13 Zyra e BE-së në Kosovë (nd) Bashkëpunimi teknik dhe financiar i Shërbimit të jashtëm Evropian për Veprim, http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/eu_kosovo/tech_financial_cooperation/index_en.htm (8 Janar 2014)
- 14 Komisioni Evropian (nd) Zgjerimi—Ndhimja financiare Kosovës, http://ec.europa.eu/enlargement/instruments/funding-by-country/kosovo/index_en.htm (8 Janar 2014)
- 15 *Devex*, 15 Tetor 2012
- 16 Ambasada e Zvicrës në Kosovë (2013) Raporti Ekonomik për Kosovën Prill 2013, 10 Shtator 2013, http://www.s-ge.com/en/filefield-private/files/42915/field_blog_public_files/18995 (20 Shtator 2013)
- 17 *Ibid.*, http://www.s-ge.com/en/filefield-private/files/42915/field_blog_public_files/18995
- 18 Borxhi publik i Kosovës deri në 16% yly deri në 475.7 milionEuro në fund të vitit 2013.' *Intellinews*, 6 Shkurt 2014, <http://www.intellinews.com/kosovo-1311/kosovo-s-public-debt-up-16-y-y-to-eur-475-7mn-at-end-2013-28663/> (24 Maj 2014)
- 19 *Op cit.*, http://www.s-ge.com/en/filefield-private/files/42915/field_blog_public_files/18995
- 20 *Op cit.*, http://www.s-ge.com/en/filefield-private/files/42915/field_blog_public_files/18995
- 21 Banka Qendrore e Kosovës (2013) Vlerësimi tremujor i ekonomisë nr. 4/Q3,Dhjetor 2013, http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2014/Q3%202013_el.pdf (3 Shkurt 2014)
- 22 Dokumenti Strategjik për Kosovën2014–2020 i Shërbimit të jashtëm Evropian për Veprim (2013) (draft versioni i Shtatorit 2013), fq.11, http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/20131025_draft_csp_for_kosovo_241013_en.pdf (30 Shtator 2013); http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf, fq.34
- 23 Blumi, I (2005) Islami politik të Shqiptarët: A janë Talibanët duke ardhur në Ballkan? Instituti Kosovar për Politikë dhe Zhvillim, http://www.kipred.org/advCms/documents/14714_Political_Islam_Among_the_Albanians_Are_the_Taliban_coming_to_the_Balkans.pdf (20 Shtator 2013)
- 24 Bislimi, B (2014) Projekt-Ligji për 'Ndotjen e Zërit' të Kosovës' inatosë komunitetet religjioze.' *Radio Evropa e Lirë Radio Liria*, 10 Shkurt 2014, <http://www.rferl.org/content/kosovo-noise-pollution-religion-muezzin/2525781.html> (10 Shkurt 2014)
- 25 Intervista me punëtorët mjekësor të veriut të Kosovës, Komuna veriore e Mitrovicës, 23 Janar 2014
- 26 Punëtorët mjekësor të veriut të Kosovës 23 Janar 2014
- 27 Punëtorët mjekësor të veriut të Kosovës 23 Janar 2014. Përdersa Kosova ende mirëmban një shkallë të lartë të rritjes së lindjeve në krahasim me mesataren

e shteteve të tjera Evropiane, të dhënat zyrtare më të fundit (2011) tregojnë një rënie të lehtë. Informatat e shkurtra nga intervistat sugjerojnë rritje të pjellorisë, si raportimi i 1,000 lindjeve gjatë vitit 2013 në një komunë të vetme Serbe (Graçanicë, e cila ka popullatë prej rreth 11,000 banorëve).

28 Ministria e Kosovës për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor (2011) Sigurimi i Ujit për Kosovën Qendrore—WEAP Model Raporti i aktiviteteve, <http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Resources/WEAP.pdf> (29 Janar 2014)

29 Raporti i Ministrisë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe Agjencisë Kosovare për Mbrojtje të Mjedisit (2010): Gjendja e ujit në Kosovë, http://www.ammk-rks.net/repository/docs/raporti_ujerave_2010-angl.pdf (15 Mars 2014)

30 BE-ja ndihmon projekte të ndryshme për infrastrukturën e ujësjellësit, me dy prej tyre—fabrikën për përpunimin e ujit në fshatin Shipol Komuna jugore e Mitrovicës dhe fabrikën në Prishtinë—të cilat ende vijojnë dhe kushtojnë mbi 15 milion Euro. BE-ja çdo vjet jap 5 milion Euro për ti ndihmuar të gjitha komunat në Kosovë për të përmirësuar ujin, kanalizimin dhe infrastrukturën tjetër si pjesë e programit të saj komunal. BE-ja gjithashtu ka dhënë ndihmë Institutit Kombëtar për Shëndetin Publik për laboratorin e monitorimit të kualitetit të ujit të pijshëm, si dhe Institutit Hidro-meteorologjik të Kosovës për furnizimin me pajisje më moderne për monitorimin dhe analizat laboratorike të kualitetit të ajrit, ujit dhe tokës. BE-ja tanimë është duke financuar një projekt për Asistencë Tenike në Ministri të Mjedisit për të ndihmuar zhvillimin e një Plani Strategjik Investues të Ujit për 10 vitet e fundit (emajli nga zyra e BE-së, 4 Mars 2014).

31 Emajli nga zyra e BE-së, 4 Mars 2014

32 Emali nga zyra e BE-së, 10 Prill 2014

33 Muhamet, M; Beqiri, E (2006) 'Korrupsioni në Kosovë—tiparet, opinionet dhe sfidat.' Plani i Veprimit për Anti-Korrupsion: Nevojat Sociale dhe Ekonomike për Kosovën, Agjencia Kosovare për Anti-Korrupsion dhe OSBE, Prishtinë, fq.17, <http://www.akk-ks.org/repository/docs/OSCEbooklet-%20ACactionplan-Dec06.pdf> (5 Shtator 2013)

34 Bunjaku, Q; Duriqi, V (2012) 'Korporata e Kosovës për Korrupsion-KEK.' Preportr, 4 Gusht 2012, <http://preportr.com/en-us/Public-assets-and-privatization/Kosovo-Corruption-Corporation-KEK-176> (10 Shtator 2013)

35 Veliu, E (2014) 'KEDS plaçk masive me njehsorë.' Zeri, 25 Shkurt 2014, <http://www.zeri.info/artikulli/27575/keds-plack-masive-me-njehsore> (25 Shkurt 2014)

36 Bunjaku, Q; Duriqi, V (2012), *ibid.*

37 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2010) Plani strategjik i Kosovës për arsimim 2011–2016, http://www.entwicklung.at/uploads/media/2c_Kosovo_Education_Strategic_Plan_EN_FINAL_DRAFT.pdf (24 Mars 2014)

38 Deutsche Welle (2014) Studentët udhëheqin me protesta të mëdha në Kosovë, 13 Shkurt 2014, <http://www.dw.de/students-lead-wide-ranging-protests-in-kosovo/a-17427474> (24 Mars 2014);

BalkanInsight (2014) Studentët e Kosovës zotohen për mbajtjen e protestave të reja kundër mashtrimit, 10 Shkurt 2014, <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-students-to-continue-protests> (24 Mars 2014)

39 Edukata qytetare është e detyrueshme në sistemin arsimorë të Kosovës.

40 Intervistë në Komunën veriore të Mitrovicës, 24 Janar 2014

41 Fokus grupi në Komunën veriore të Mitrovicës, 23 Janar 2014

42 Shembujt janë revista Novi standard, Nase novine, SRPski FBReporter dhe faqet nga Facebook Kosovska Mitrovica dhe Tehnicka skola

43 Trepça (2010) Trepça, e gatshme për eksploitim, <http://www.trepca-akp.com/2010/01/trepca-ready-for-exploitation/11/> (20 Janar 2014)

44 Intervistat me inxhinierët e minierave dhe ish punëtorë të Trepçës, Komuna veriore e Mitrovicës, 27 Janar 2014

45 Synovitz, R (2013) 'Ekonomia e Kosovës ende po lufton pesë vite pas pavarësisë.' Radio Evropa e Lirë Radio Liria, 14 Shkurt 2013, <http://www.rferl.org/content/kosovo-economy-struggling/24901946.html> (20 Shtator 2013)

46 Savic, M (2014) 'Serbia kërkon investime në minierat e Trepçës përpara bisedave me Kosovën.' Bloomberg, 17 Maj 2014, <http://www.bloomberg.com/news/2013-05-17/serbia-seeks-investment-in-trepca-mines-ahead-of-kosovo-talks.html> (22 Maj 2014)

47 Bexhet, M et al. (2012) 'Vegjetacioni në pirgjet e hirit të termocentralit Kosova A dhe në pirgun e shllakës së shkrites së Ferronikelit në Kosovë.' Revista hulumtuese e Shkencave për Mjedisin Tokësor 4(9): 823-834, Shtator 2012, <http://maxwellsci.com/print/rjees/v4-823-834.pdf> (3 Shkurt 2014)

48 Zoi Rjeti i Mjedisit në emër të Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedis (2010) Studimet e rastit për plumbin dhe kontaminimin nga metalet e rënda në Mitrovicë, Kosovë: Rreziqet e mjedisit nga punishtet e braktisura të përpunimit të xehes dhe mineraleve në Veri të Kosovës (drafti i parë), Gjenevë/Amsterdam, http://www.chem.unep.ch/pb_and_cd/documents/unep_mitrovica_case_study.pdf (3 Shkurt 2014)



PAX

Codebaldkwartier 74
3511 DZ Utrecht
The Netherlands

www.paxforpeace.nl
info@paxforpeace.nl
+31(0)30 233 33 46

P.O. Box 19318
3501 DH Utrecht
The Netherlands